



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 70, datë 1.10.2018**

**PËR**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: RREGULLIMI I TARIFAVE TË  
SIPËRMARRËSVE ME FNT NË TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT TE  
THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE - DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. \_\_\_\_\_, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*

**BAZA LIGJORE:**

- 1) Neni 55 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
- 2) Rregullore Nr.9, “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
- 3) Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.11, datë 22.02.2018, për “Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar””
- 4) Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.12-14, datë 22.08.2018, për përcaktimin e sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a dhe

Albtelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-Këshillim Publik 2*”;
2. Dokumenti i përgatitur nga DRRES “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, i cili përmban si Aneks 1: *Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet*;
3. Projekt-vendimi për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar*”;
4. Projekt-Vendimet për rregullimin e tarifave me shumicë të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale celulare;
5. Relacioni shpjegues për Projektvendimet (**Relacioni**);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

### **V Ë R E N:**

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”, për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Dokumenti u publikua ne faqen e Internetit te AKEP dhe këshillimi publik u krye për një afat kohor dy mujor deri me datë 7.02.2017.
2. Bazuar në kërkesën e Vodafone Albania, Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, vendosi për shtyrjen e periudhës së këshillimit publik të këtij dokumenti si dhe dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare -Këshillim Publik*” për një afat maksimal jo më shumë se 60 ditë nga data 16.02.2017. Njoftimi për shtyrjen e afatit të këshillimit publik u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe i’u dërgua në rrugë shkresore palëve kryesore të interesuara.
3. Pas këshillimit publik, KD i AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 për “*Miratimin e Dokumentit "Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar"*;

4. KD i AKEP me vendimet Nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018, vendosi për përcaktimin respektivisht të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a dhe Altelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT
5. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.15, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit për *“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare–Këshillim Publik 2”* . Periudha e konsultimit publik ishte 26.02.2018 – 29.03.2018.
6. Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara:
  - a) Autoriteti i Konkurrencës me shkresën NR.155/1, datë 29/03/2018 (referenca e AKEP Nr.2285/21 prot., datë 05.04.2018);
  - b) Altelecom sh.a me shkresën Nr.2745, datë 28/03/2018 (referenca e AKEP Nr.2285/18 prot., datë 28.03.2018);
  - c) Vodafone Albania sh.a me shkresën LEA/030/1L, datë 29/03/2018 (referenca e AKEP Nr.2285/20 prot., datë 29.03.2018);
  - d) Telekom Albania sh.a me shkresën Nr.2166, datë 27/03/2018 (referenca e AKEP Nr.2285/19 prot., datë 29.03.2018).
7. Struktura përgjegjëse e AKEP pasi ka shqyrtuar komentet e palëve të interesuara ka përgatitur dokumentin, *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*, i cili:
  - a) është përgatitur në përputhje me nenin 55 të Ligjit 9918 pas procedurës së këshillimit publik dhe ka marrë në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara, dhe komentet kryesore dhe qëndrimi i AKEP për komentet është pjesë e tij (Aneks 1);
  - b) ka marrë në konsideratë praktikën më të mira në vendet e BE dhe rajonit dhe kushtet e tregut Shqiptar;
  - c) është përgatitur në përputhje me përcaktimet në dokumentin, *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar”*, miratuar me Vendimin Nr.11, datë 22.02.2018, dhe përcaktimet e Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.12-14, datë 22.02.2018, për përcaktimin e sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a dhe Altelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT;
  - d) është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm mbi të cilin bazohet arsyetimi për vendimet për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a dhe Altelecom sh.a. të përcaktuar me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare dhe masat përkatëse rregulluese nëpërmjet Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.12, 13 dhe 14, datë 22.2.2018.

- e) ka një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe në përfitimet e përdoruesve fundore nga rritja e konkurrencës në tregun celular.
8. Diskutimi i dokumentit deri në versionin përfundimtar ka qenë një proces dinamik i zhvilluar në disa mbledhje të Këshillit Drejtues ku janë parashtruar komente, vërejtje dhe sugjerime të cilat janë marrë në konsideratë në procesin e përmirësimit të dokumentit të analizës së tregjeve dhe masave rregullatore ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse në funksion të realizimit të qëllimit të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” për sigurimin e konkurrencës efektive.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë dokumentin *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit te thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit te thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

### **ANËTARË:**

1. Alban **KARAPICI**
2. Edlira **DVORANI**
3. Ketrin **TOPÇIU**
4. Klarina **ALLUSHI**



# **Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit te thirrjeve në rrjetet celulare**

**Dokumenti Përfundimtar**

**Miratuar me VKD nr.70, datë 1.10.2018**

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje .....	4
2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ne Shqiperi.....	6
3. Tarifat benchmark të terminimit në rrjetet celulare .....	9
1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator.....	9
2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC .....	10
3. Tarifa mesatare MTR e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër .....	14
4. Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark).....	16
5. Asimetria/Simetria e MTR ne vendet BE/BEREC .....	17
4. Rishikimi i tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri .....	20
1. Metoda e rregullimit të MTR .....	21
1. Benchmarku i përshtatshëm për MTR.....	22
2. Asimetria/Simetria dhe afati i aplikimit të MTR të ri.....	23
5. Efektet e ndryshimeve të MTR.....	30
Aneks 1: Komentet e këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP .....	32
Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve .....	70

## Lista e Tabelave dhe Figurave

<b>FIGURA 3.1: TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREK (KORRIK 2016)</b> .....	12
<b>FIGURA 3.2 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREK (KORRIK 2017)</b> .....	13
<b>FIGURA 3.3 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREK (JANAR 2018)</b> .....	13
<b>TABELA 3.1: MTR DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR BEREK 2016-2017</b> .....	14
<b>TABELA 3.2: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK KORRIK 2016- KORRIK 2017)</b> .....	16
<b>TABELA 3.3: VENDET ME TARIFA TERMINIMI ASIMETRIKE KORRIK 2016</b> .....	18
<b>FIGURA 3.4: ASMITERIA E MTR NË VENDET EVROPIANE JANAR 2009-JANAR 2018</b> .....	19
<b>TABELA 4.1: ASIMETRIA E TARIFAVE TË TERMINIMIT TË ALBTELECOM DHE PLUS</b> .....	24
<b>FIGURA 4.1: ECURIA E TRAFIKUT DHE TË ARDHURAVE NETO MIDIS TRE OPERATORËVE CELULARE 2014-18</b>	25
<b>TABELA 4.2: ALTERNATIVA PËR RREGULLIMIN E MTR</b> .....	27
<b>TABELA 4.3: PROPOZIMI I AKEP PËR MTR NË KËSHILLIM PUBLIK (SHKURT 2018)</b> .....	28
<b>TABELA 4.4: PERCAKTIMI FINAL I AKEP PËR RISHIKIMIN E MTR (2018-2020)</b> .....	29
<b>TABELA 5.1: IMPAKTI I MTR NË KOSTOT ME SHUMICË TË THIRRJEVE CELULARE</b> .....	31

# 1. Hyrje

---

Dokumenti përfundimtar “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-dokumenti përfundimtar*” miratohet pas këshillimit publik dy mujor të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare-këshillim publik*” dhe pas këshillimit publik 30 ditor të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-këshillim publik*”.

Procedura në mënyrë të detajuar filloi nga AKEP nëpërmjet Vendimit Nr.2699, datë 01.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare- Këshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut ishte 7-12.2016 -7.02.2017. Në lidhje me FNT në treg, AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik propozoi që të katër sipërmarresit e rrjeteve celulare të vijojnë të percaktohen me statusin e FNT për terminimin e thirrjeve në secilin prej rrjeteve të tyre.

Në lidhje me masat rregulluese AKEP propozoi që operatorët celulare të vijojnë zbatimin e masave rregulluese të percaktuara nga analiza e mëparshme e tregut celular, transparencë, mos-diskriminimi, përfshirë detyrimin e mos-diskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net, detyrimi për akses dhe interkoneksion, si dhe detyrimin për kontrollin dhe rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve të katër operatoreve celulare.

Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të terminimit, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar së do të zhvillojë një proces të veçantë këshillimi publik, në përputhje me percaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të percaktuar metodën e kontrollit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në këto tregje përkatës.

Në përputhje me sqarimin e cituar, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”, për të percaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe keshillimi publik u krye në periudhën 22.12.2016-7.02.2017.

Bazuar në kërkesën e Vodafone Albania, Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, vendosi për shtyrjen e periudhës së këshillimit publik të këtij dokumenti si dhe dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare -Këshillim Publik*” për një afat maksimal jo më shumë se 60 ditë nga data 16.02.2017. Njoftimi për shtyrjen e afatit të këshillimit publik u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe i'u dërgua në rrugë shkresore palëve kryesore të interesuara.

AKEP me shkresën Nr.1907/9 Prot., datë 8.05.2017, kërkoi që operatorët deri më 15.05.2017 të depozitonin pozicionin final të tyre për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016 për analizën e tregut celular. AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular (me delajen nga tregu të Plus Communication më



1.01.2018), brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

Pas marrjes së komenteve, AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 miratoi dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar” dhe me Vendimet nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018 vendosi:

- “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”.

Në lidhje me masën rregulluese të rregullimit të MTR, AKEP bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018, ka përgatitur këtë version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR për këshillim publik me palët e interesuara. Për të dalluar nga dokumenti i parë i nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, dokumenti i nxjerrë në këshillim publik në Shkurt 2018 titullohej “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik 2”.

Pyetjet e këshillimit publik, përgjigjet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik janë përfshirë në Aneks 1 të këtij dokumenti përfundimtar “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-dokument i përfundimtar”.

## 2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ne Shqiperi

---

Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka qene objekt rregullimi ex-ante nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC<sup>1</sup> i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare.

AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom.

Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122, datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communication.

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e koston 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus me vendimet e dates 4.07.2012 u vendos qe tarifa e terminimit te arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015.

AKEP me vendimet nr.2431-2435, date 13.03.2014, vendosi qe tarifat e terminimit te kater operatoreve te reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 per te arritur ne nivelin 1.48 lek/minute ne 1.01.2016, e cila eshte sa vlera mesatare e tarifave te terminimit ne vendet Evropiane qe kane aplikuar LRIC te paster ne vitin 2013.

Bazuar në gjetjet e analizes se tregut 2014, AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, percaktoi qe tarifa 1.48 lek/minute te fillonte te aplikohet qe prej dates 1.12.2014 per Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, ndersa tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te qendronte ne vleren 6.52 lek/minute deri ne nje vendim tjetet te AKEP.

Bazuar ne procesin e shqyrtimit te ankimeve administrative te kater operatoreve celulare per vendimet e dates 6.11.2014, AKEP me Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015, ndryshoi tarifen e terminimit ne rrjetin Plus (te percaktuar me vendimet e dates 6.11.2014), duke percaktuar nje glidepath (reduktim te pershkallezuar) ne menyre qe tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te arrinte

---

<sup>1</sup> *Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Koston Mesatare Inkrementale Afatgjatë)*

nivelin 1.48 lek/minute me date 1.01.2016. Reduktimi u percaktua te kryhej me dy faza te ndermjetme qe fillonin me 1.04.2015 dhe 1.07.2015.

AKEP në vijim të Vendimeve për monitorim të situates ne treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD nr.2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatorët për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.

AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit te filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR-ve për të gjithë operatorët.

### **Proceset gjyqesore**

Sipermarresi Plus Communication sh.a ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin nr.2542, date 13.03.2015 duke kerkuar shfuqizimin e ndryshimeve te kryera nepermjet ketij vendimeve per tarifen e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Plus dhe afatin e fillimit te aplikimit te detyrimit te mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.1567 datë 1.04.2016 ka pranuar kërkesë padine e Plus Communication. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016, ka lene ne fuqi vendimin të Gjykates Administrative të Shkallës së Parë, Tirane.

AKEP ka depozituar në Gjykatën e Lartë rekurs në lidhje me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe është në pritje të sqarimeve nga Gjykata e Lartë.

Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelcom ankimuan Vendimin 2664/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.80-2016-4342, datë 26.09.2016, pranoi kerkese padine e tre operatoreve. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Plus Communication ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin 2676/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 80-2016-5079, datë 31/10/2016, pranoi kerkese padine e Plus. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 09678-80-2016 datë 18.01.2017, me objekt “Sqarim dhe interpretim Vendimi”, ka bërë sqarimin në lidhje me vendimin e saj të datës 31.10.2016, se bazuar në vendimet e mëparshme të gjykatës adminsitrative (datë 1.04.2016 dhe 9.09.2016), tarifa e terminimit e aplikueshme për Plus nga data 1.04.2015 është 6.52 lek/minutë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, më datë 5.10.2017, me Vendimin Nr. 00 - 2017 – 1841, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit; rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Vodafone Albania”; rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Albtelcom” sh.a dhe rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Telekom Albania” sh.a, kundër vendimit nr. 2459, datë 09.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Duke qënë në kushtet kur:

- Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 1567, date 01.04.2016 ka vendosur lënien në fuqi fuqi të tarifës së terminimit te PLUS ne nivelin 6.52 deri ne Analizen e radhes se tregut celular (vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Apelit),
- AKEP nuk gëzon të drejtën për interpretim te vendimeve te gjyqesorit, dhe në vijim edhe të marrevshjeve midis vetë operatorëve celularë, në seksionet e mëposhtme si tarifë terminimi në rrjetin Plus Communication në periudhën 1.04.2015-31.12.2017 është dhënë vlera 6.52 lek/minutë.

### 3. Tarifat benchmark të terminimit në rrjetet celulare

---

Ky kapitull përmban informacion mbi dokumentat e KE dhe BEREC që kanë lidhje me tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Në seksionin e parë përshkruhen elementet kryesore të rekomandimeve të KE për tarifat e terminimit, ndërsa seksionet e tjera përmbajnë informacion në lidhje me tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC dhe krahasime të këtyre tarifave me tarifat e terminimit në Shqipëri.

Tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC në dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, të publikuar në Dhjetor 2016, janë përditësuar sipas dokumenteve më të fundit të publikuar nga BEREC, duke dhënë shënimet/sqarimet përkatëse.

#### 1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator

Komisioni Europian, BEREC në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, ka rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Europian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifat duhet të jenë simetrike. Për përcaktimin e shkallës minimale të eficensës për operatorët celularë rekomandohet të përdoret një operator me pjesë tregu 20%;
- Vlerësimi i kostove efiente të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metodën BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Rregullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD, i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC+;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstrohet se hyrësit e rinj kanë dizavantazh në raport me operatorët e tjerë.
- Vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli kostosh LRIC të pastër mund të përdorin metodën benchmark duke i'u referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.

Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë, dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC).

Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe njëkohësisht ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit.

### **Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike**

KE nëpërmjet dokumentit të datës 14.09.2016, COM(2016) 590 final 2016/0288 (COD) “*Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL establishing the European Electronic Communications Code*”,<sup>2</sup> ka propozuar për rishikimin e direktivave të komunikimeve elektronike nëpërmjet hartimit të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike. Në lidhje me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, KE ka propozuar ndër të tjera që:

- Në rastet kur autoriteti rregullator kombëtar për operatorët me FNT për terminimin e thirrjeve vendos masën e kontrollit të tarifës dhe orientimit në kosto, rregullatori duhet të përcaktojë tarifa maksimale simetrike për terminimin bazuar në kostot e një operator eficient;
- KE do të përcaktojë një çmim tavan për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, i cili nuk do të jetë më i madh se 1.23 eurocent/minutë;
- Metodologjia e kostove duhet të bazohet në kostot korrente dhe në modelin Bottom-Up duke përdorur kostot LRIC të lidhura me trafikun për ofrimin e shërbimit të terminimit palëve të tjera;
- KE, në bashkëpunim me BEREC, do të përcaktojë specifikime për modelin e kostove dhe metodologjia e kostove dhe çmimi tavan për terminimin do të rishikohen çdo 5 vjet nga Komisioni.

KE në lidhje me çmimin tavan të propozuar shpjegon se modelet LRIC të pastër kanë prodhuar vlera të kostove që variojnë nga 0.4045 në 1.226 eurocent për minutë. Rishikimi i direktivave të KE është ende në proces miratimi.

## **2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC**

Për sa i përket nivelit të tarifave mesatare të aplikuara në vendet e BE dhe BEREC, AKEP ka grumbulluar informacion duke i referuar burimeve të mëposhtme:

- Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare;
- Të dhëna të publikuara nga BEREC dhe Cullen International në lidhje me metodën e rregullimit të MTR-ve.

AKEP në dokumentat e mëparshme për tarifën benchmark të terminimit në rrjetet celulare ka përdorur të dhëna të publikuara nga KE dhe nga BEREC. Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifën e terminimit në vendet e BE, përmbajnë tarifën e aplikuara në 28 vendet anëtare të BE në vitin 2014, dhe KE nuk ka publikuar më të dhëna për këtë tregues në faqen eeb për axhendën digitale. Të dhëna më të përditesuara dhe detajuara për tarifën e terminimit në vendet e BE-së tashmë mund të gjenden në publikimet e BEREC, dhe AKEP në

---

<sup>2</sup> Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Parlamenti dhe Këshilli Europian fundi i vitit 2017.

këtë dokument i referohet kryesisht këtij burimi të dhënash në lidhje me tarifat e terminimit të aplikuar në vendet e BE dhe BEREC dhe metodën e përdorur për rregullimin e tyre.

### **Tarifat mesatare të terminimit celular (MTR) në vendet e BE/BEREC**

BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC. Në listen e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC, në kohën e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit për MTR nga AKEP në Dhjetor 2016 ishte dokumenti *BoR (16) 218 "Termination rates at European level-July 2016" December 2016*,<sup>3</sup> i cili paraqet situatën e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 Korrik 2016.<sup>4</sup> Dokumenti i BEREC përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit përmban informacion të detajuar edhe për tarifën e terminimit sipas operatorëve në çdo vend dhe metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe 'glide path' të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.

Figura e mëposhtme paraqet tarifën mesatare të terminimit MTR në secilin prej vendeve të BEREC të aplikuar më 1 Korrik 2016, si dhe tarifën mesatare në nivel BE 28 dhe në të gjitha vendet e BEREC (37 vende). Në këtë publikim për herë të parë përfshihet dhe Shqipëria<sup>5</sup> si vend që aderon në BEREC.


---

<sup>3</sup> [http://berec.europa.eu/eng/document\\_register/subject\\_matter/berec/reports/6603-termination-rates-at-european-level-july-2016](http://berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/6603-termination-rates-at-european-level-july-2016)

<sup>4</sup> Për të ruajtur kohëzgjatësinë me dokumentin e nxjerrë në këshillim publik të benchmark përditësimi sipas dokumentin më të fundit të BEREC për Korrik 2017 është dhënë në një seksion më vete më poshtë.

<sup>5</sup> Për Shqipërinë tarifa e terminimit më 1.07.2016 është raportuar në nivelin 1.48 lek/ minutë për të katër operatorët sipas vendimeve të AKEP, me shënimin se tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication është objekt i Vendimeve të Gjykatave të RSH.

**FIGURA 3.1: TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREC (KORRIK 2016)**



Burimi: BEREC, BoR (16) 218, Dhjetor 2016

Nga të dhënat vihet re se tarifat MTR në vendet BEREC variojnë nga 0.4 eurocent në Maltë në 5.9 eurocent në Zvicër (vend që nuk bën rregullim ex-ante të MTR-ve). Tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC variojnë nga 1.04 eurocent/min, që është mesatarja e thjeshtë aritmetike në 28 vendet anëtare të BE (AvEU28(S)) deri në 1.27 eurocent/min që është mesatarja e thjeshtë aritmetike e 37 vendeve të BEREC (Average S). Tarifa e terminimit në Shqipëri është pak më e lartë se mesatarja e thjeshtë në vendet e BE, por më e ulët se tre mesataret e tjera të përlogarituar nga BEREC.

Figura e mëposhtme përmban një përditësim të informacionit mbi tarifat benchmark të MTR në vendet e BE dhe BEREC deri në Korrik 2017 sipas dokumentit më të fundit të BEREC BoR (17) 227 “Termination rates at European level-July 2017” 7 December 2017<sup>6</sup>.


<sup>6</sup> [http://www.berec.europa.eu/eng/document\\_register/subject\\_matter/berec/reports/7524-termination-rates-at-european-level-july-2017](http://www.berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/7524-termination-rates-at-european-level-july-2017)



### FIGURA 3.2 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREC (KORRIK 2017)

MTR per country – July 2017 (eurocents per minute of service)

Figure 2 MTRs



Source: NRAs, BEREC


Burimi: BEREC, BoR (17) 227, Dhjetor 2017

Dokumenti i mësipërm i BEREC ishte publikimi më i fundit në kohën e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit për MTR. BEREC në Qershor ka publikuar të dhënat më të fundit për MTR në deri më 1.01.2018, të cilat janë dhënë në figurën e mëposhtme.

### FIGURA 3.3 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREC (JANAR 2018)

MTR per country – January 2018 (eurocents per minute of service)

Figure 2 MTRs



Burimi: BEREC, BoR (18) 103, Qershor 2018

Sipas të dhënave të këtij dokumenti të BEREC tarifat MTR mesatare në vendet e BE/BEREC janë nga 0.8577 eurocent (1.14 lek)<sup>7</sup> deri në 0.9684 eurocent (1.29 lek) që i referohen niveleve mestatare të thjeshta dhe të ponderuara të 28 vendeve të BE dhe 37 vendeve të BEREC.

### 3. Tarifa mesatare MTR e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër

Në vijim të vendim-marrjeve të AKEP në Mars 2014 e në vijim për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri bazuar në tarifat benchmark të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i paster (Pure BU-LRIC), në këtë seksion AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me aplikimin e këtij modeli dhe nga vendet anëtare të BEREC dhe vlerat përkatëse mesatare, që mund të perdoren si benchmark për rregullimin e MTR-ve në Shqipëri.

Tabela e mëposhtëme paraqet vlerat e tarifave të terminimit në 37 vendet që raporton BEREC, më 1.07.2016-1.07.2017. Informacioni është marrë nga 2 raportet e BEREC të publikuar në Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017.

**TABELA 3.1: MTR DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR BEREC 2016-2017**

Nr.	Shteti	Modeli (1.07.2017)	Tarifa e terminimit (eurocent/min)		
			1.07.2016-31.12.2016	1.01.2017-30.06.2017	1.07.2017-31.12.2017
1	AT	Pure BU-LRIC	0.8049	0.8049	0.8049
2	BE	Pure BU-LRIC	1.1800	1.1800	0.9900
3	BG	Pure BU-LRIC	0.9715	0.9715	0.7158
4	CZ	Pure BU-LRIC	0.9985	0.9985	0.9346
5	DK	Pure BU-LRIC	0.7272	0.7272	0.6359
6	EL	Pure BU-LRIC	1.0810	1.0810	0.9820
7	ES	Pure BU-LRIC	1.0900	1.0900	1.0900
8	FR	Pure BU-LRIC	0.7600	0.7400	0.7400
9	HR	Pure BU-LRIC	0.8395	0.8395	0.6326
10	HU	Pure BU-LRIC	0.5457	0.5457	0.5520
11	IT	Pure BU-LRIC	0.9800	0.9800	0.9800
12	LU	Pure BU-LRIC	0.9700	0.9700	0.8900
13	MT	Pure BU-LRIC	0.4045	0.4045	0.4045
14	NO	Pure BU-LRIC	0.6976	0.6976	0.6932
15	PL	Pure BU-LRIC	0.9814	0.9814	1.0178
16	PT	Pure BU-LRIC	0.8100	0.8100	0.7500
17	RO	Pure BU-LRIC	0.9600	0.9600	0.9600

<sup>7</sup> Kursi i kwmbimit sipas dokumnetit tw BEREC BoR (18) 103, Qershor 2018: 1 Euro=133.4519 Lek.

18	SE	Pure BU-LRIC	0.8159	0.7426	0.6634
19	SI	Pure BU-LRIC	1.1400	1.1400	1.1400
20	SK	Pure BU-LRIC	1.2260	1.2260	1.2260
21	UK	Pure BU-LRIC	0.6393	0.6323	0.57483
22	IE*	Pure BU-LRIC	2.6000/0.8200	0.8200	0.8200
23	AL**	Benchmark BU-LRIC	1.0699	1.0699	1.3352
24	CY	Benchmark BU-LRIC	1.0112	0.9900	0.9900
25	EE	Benchmark BU-LRIC	0.9200	0.9200	0.9200
26	IS	Benchmark BU-LRIC	1.0032	0.8813	1.069
27	LT	Benchmark BU-LRIC	0.9400	0.9400	0.9400
28	LV	Benchmark BU-LRIC	1.0500	1.0500	1.0500
29	FI	other (FDC/FAC)	1.2500	1.2500	1.2500
30	CH	Not regulated	5.9232	5.9232	3.3361
31	NL	Pure BU-LRIC	1.8610	1.8610	0.5810
32	DE	Pure BU-LRIC	1.6600	1.6600	1.1000
33	MK	TD LRIC	1.4588	1.4588	1.0220
34	TR	BU LRAIC+	0.8064	0.8064	0.6687
35	LI	Benchmarking	3.5581	3.5581	3.5971
36	RS	Benchmarking	2.2357	1.6829	1.6838
37	ME	TD LRIC	1.1800	1.1800	1.0600
<b>Mesatare Pure BU-LRIC</b>		<b>Eurocent</b>	<b>0.8838</b>	<b>0.8792</b>	<b>0.8283</b>
		<b>LEK</b>	<b>1.22</b>	<b>1.20</b>	<b>1.11</b>

\*Në Irlandë (IE) aplikimi i vlerës 0.82 eurocent sipas modelit Pure BULRIC ka filluar të aplikohet nga Shtatori 2016.

\*\*Për MTR të Shqipërisë në 2 dokumentat e cituar të BEREC janë dhënë sqarimet e duhura.

Nga tabela vihet re se deri në Korrik 2016 modeli LRIC i pastër (Pure BU-LRIC) është aplikuar në 21 vende, ndërsa deri në fund të vitit 2016 është shtuar edhe Irlanda, duke e çuar në 22 numrin e vendeve që kanë aplikuar këtë model kostoje për tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Tarifa mesatare e ketyre 22 vendeve për vitin 2016 është 0.8838 eurocent/minutë apo 1.22 lek/minutë (kursi i kembimit i perdorur 1 Euro=138.33 lek si edhe në raportin e BEREC). Në disa vende rregullatorët kanë vendosur për aplikim të *glide path* dhe tabela pasqyron edhe vlerat që aplikohen në gjashtemujorin e parë 2017. Ndryshimi midis dy periudhave është i vogël dhe mesatarja në eurocent për 22 vendet me model kostoje Pure BULRIC është 0.8792 eurocent, ndërsa në lek është 1.20 lek/minutë (duke përdorur kursin e këmbimit të publikuar nga BEREC për MTR më 1.01.2017).

Sipas dokumentit më të fundit të BEREC për MTR në Korrik 2017, nga 37 vende 24 prej tyre tashmë kanë aplikuar modelin *Pure LRIC* dhe mesatarja e MTR të këtyre vendeve rezulton 1.11 lek/minutë.

Siç mund të vihet re edhe nga tabela, 6 vende (përfshirë Shqipërinë) rregullojnë tarifën e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifa benchmark nga vendet që kanë aplikuar modelin ‘Pure-BULRIC’. Tarifën e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatës në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BULRIC në vendet e tjera europiane/BE.

Në Shqipëri, AKEP ka përcaktuar vlerën 1.48 lek/minutë në vitin 2014 duke përdorur tarifën mesatare prej 1.0550 eurocent<sup>8</sup> të 13 vendeve që kishin aplikuar modelin Pure BULRIC deri në fund të vitit 2013. Rregullimi më i fundit i bazuar në metodën ‘*benchmark pure BULRIC*’ është kryer në Islande, e cila ka përllogaritur vlerën benchmark prej 0.8813 eurocent/min në Gusht 2016 dhe kjo vlerë do aplikohet duke filluar nga Janari 2017. Vlera benchmark e përllogaritur nga Islanda është shumë afërt me mesataren e llogaritur nga AKEP në tabelën e mësipërme në eurocent, ndërsa është e njëjtë me vlerën e shprehur në Lek me dy shifra pas presjes dhjetore (1.22 lek sipas Kursit të Këmbimit në Korrik 2016).

#### 4. Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare benchmark të diskutuara se seksionet e mëparshme dhe gjatë këshillimit publik. Kursi i këmbimit i përdorur për periudha të ndryshme i referohet kursit të këmbimit të publikuar nga BEREC në dokumentin përkatës.

**TABELA 3.2: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK KORRIK 2016-KORRIK 2017)**

	Jul-16		Jan-17		Jul-17	
	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK
<b>Average BEREC (Pure LRIC)</b>	<b>0.8838</b>	<b>1.22</b>	<b>0.8792</b>	<b>1.20</b>	<b>0.8283</b>	<b>1.11</b>
<b>Average EU28(S)</b>	1.0435	1.44	0.9372	1.28	0.8795	1.18
<b>Average EU28 (W)</b>	1.0836	1.50	0.9480	1.29	0.9079	1.22
<b>Average BEREC 37(S)</b>	1.1358	1.57	0.9692	1.32	0.9262	1.24
<b>Average BEREC 37(W)</b>	1.2743	1.76	1.0991	1.50	1.0565	1.42
<b>Albania (AVG 3 MNO)</b>	1.0699	1.48	1.0874	1.48	1.1014	1.48
<b>Ndryshimi BEREC (Pure LRIC)/Albania</b>	-17%	-18%	-19%	-19%	-25%	-25%

*Burimi: Dokumentat e BEREC dhe llogaritje të AKEP.*

Nga tabela e mësipërme si dhe nga informacioni i seksioneve të mëparshme mund të arrihet në përfundimet se:

<sup>8</sup> Ndryshimi nga 1.0550 eurocent në 1.0699 eurocent për MTR e Shqipërisë vjen për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit euro/lek.

- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 Korrik 2016 ishte 1.44 lek/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.50 lek/minutë. Këto vlera janë shumë të përafërta me nivelin aktual të MTR në Shqipëri prej 1.48 lek/minute, me ndryshim +1% dhe -2%;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 Korrik 2016 ishte 1.57 lek/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.76 lek/minutë. Këto vlera janë 6% dhe 19% më të larta se niveli aktual prej 1.48 lek/minutë në Shqipëri;
- Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BEREC në Korrik 2016 është reduktuar me 43% (mesatarja e thjeshtë) dhe 22% (mesatarja e ponderuar) në krahasim me Korrik 2013;
- Deri në vitin 2013 nga 34 vende të BEREC, 13 vende kishin aplikuar tarifën e terminimit celular bazuar në modelin e kostove BU-LRIC të pastër, dhe vlera mesatare ishte 1.055 eurocent/minutë apo 1.48 Lek/minute;
- Deri në vitin 2016 nga 37 vende të BEREC, 22 vende kanë aplikuar modelin BU-LRIC të pastër, dhe 6 vende kanë aplikuar benchmark mbi tarifën e aplikuar në vendet me këtë model kostoje;
- Tarifa mesatare e terminimit e 22 vendeve që kanë aplikuar modelin BU LRIC të pastër deri në fund të vitit 2016 është 0.8838 eurocent/minutë, apo 1.22 lek/minute;
- Tarifat e terminimit në rrjetet celulare janë simetrike në pothuajse të gjitha vendet e BEREC që prej vitit 2013, me përjashtim të 3 vendeve, por edhe këto me specifika të veta dhe me nivele shumë të ulëta të asimetrisë në terma absolute.

#### **Nga përditësimi i tarifave benchmark të MTR në Korrik 2017 rezulton se:**

- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 Korrik 2017 ishte 1.18 lek/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.22 lek/minutë. Këto vlera janë 18-20% më të ulëta se niveli aktual i MTR në Shqipëri prej 1.48 lek/minute;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 Korrik 2017 ishte 1.24 lek/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.42 lek/minutë. Këto vlera janë respektivisht 16% dhe 4% më të ulëta se niveli aktual prej 1.48 lek/minutë në Shqipëri;
- Deri në Korrik 2017 nga 37 vende të BEREC, 24 vende kanë aplikuar modelin BU-LRIC të pastër, dhe 6 vende (përfshirë Shqipërinë) kanë aplikuar benchmark mbi tarifën e aplikuar në vendet me këtë model kostoje;
- Tarifa mesatare e terminimit e 24 vendeve që kanë aplikuar modelin BU LRIC të pastër deri në Korrik 2017 është 0.8283 eurocent/minutë, apo 1.11 lek/minute krahasuar me 1.22 lek/minutë që ishte deri në fund të vitit 2016;
- Tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC në Korrik 2017 janë reduktuar me 6-18% në krahasim me Korrik 2016 (krahasimi në vlerat në eurocent) dhe këto tarifa mesatare (të shprehura në lek) në Korrik 2017 janë 4-25% më të ulëta se tarifa 1.48 lek/minutë.

#### **5. Asimetria/Simetria e MTR në vendet BE/BEREC**

Rekomandimi i vitit 2009 të KE për tarifën e terminimit rekomandoi përdorimin e metodës Pure BULRIC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare dhe fikse, përfshirë aplikimin e tarifave

simetrike. Seksioni i mëparshëm evidentoi se përdorimi i modelit Pure BULRIC dhe benchmarkut sipas këtij modeli është rritur ndjeshëm, dhe tashme ato përdoren në 28 vende nga 37 vende të BEREC. Raporti i BEREC 2016 paraqet gjithashtu informacion për nivelin e MTR-ve për secilin operator rrjeti celular dhe MVNO në vendet përkatëse, ku mund të evidentohet aplikimi ose jo i asimetrisë dhe niveli i saj. Nga ky informacion rezulton se nga 37 vende të BEREC vetëm në 3 vende (Zvicër, Qipro dhe Turqi) aplikohet ende asimetri në tarifën e terminimit në rrjetet celulare. Tabela e mëposhtme paraqet informacionin e publikuar nga BEREC si dhe nivelin e asimetrisë së perlogaritur nga AKEP për këto 3 vende.

**TABELA 3.3: VENDET ME TARIFA TERMINIMI ASIMETRIKE KORRIK 2016**

Country	Operator	Average effective prices (€cent)	Subscribers	Country total subscribers	Market Share %	Niveli i Asimetrise	
						Ne perqindje	Ne lek
CH	Swisscom	5.4283	6,561,442	10,711,066	61.26%		
	Sunrise	6.7056	2,413,228		22.53%	24%	1.77
	Salt	6.7056	1,736,396		16.21%	24%	1.77
CY	Cyta	0.99	689,406	1,135,324	60.72%		
	Primetel	1.39	60,657		5.34%	40%	0.55
	MTN	0.99	376,504		33.16%		
TR	Turkcell	0.7643	32,573,556	73,650,996	44.23%		
	Vodafone	0.7888	23,044,383		31.29%	3%	0.03
	Avea	0.9049	18,033,057		24.48%	18%	0.19

*Burimi: BEREC dhe llogaritje të AKEP.*

Nga tabela vihet re se niveli i asimetrisë në këto tre vende varion nga 3% në Turqi në 40% në Qipro, ndërsa niveli absolut i diferencës në tarifa varion nga 0.03 Lek në Turqi në 1.77 Lek në Zvicër.

Në Zvicër (CH) aplikohet asimetri prej 24% midis dy operatoreve më të vegjël dhe operatorit lider me 61% pjesë tregu në pajtimtarë. Megjithatë, në Zvicër tarifën MTR nuk janë objekt rregullimi ex-ante, ato rregullohen vetëm ex-post në rast të mos-marrveshjeve midis operatorëve. Niveli i tarifave MTR të Zvicres është shumë herë më i lartë se në vendet e tjera europiane.


Në Qipro niveli i asimetrisë për operatorin më të vogël në treg është 40%. Primetel ka filluar ofrimin e shërbimeve celulare në vitin 2014 dhe sipas vendimit të rregullatorit në vitin 2015 asimetria për vitin 2016 është 40%, për vitin 2017 do jetë 20% dhe në Janar 2018 tarifën e këtij operatori do jenë simetrike me dy operatorët e tjere.

Në Turqi, aplikohet asimetri midis dy operatoreve më të vegjël dhe operatorit lider në nivel 3% dhe 18%. Kjo asimetri ka vite që aplikohet bazuar në vendimet e rregullatorit në vitin 2013. Niveli i asimetrise në vlerë absolute është shumë i ulët, 0.03 dhe 0.19 lek, për shkak se niveli i

tarifave të terminimit të tre operatorëve janë afërsisht ose më të ulëta se niveli mesatar në vendet që aplikojnë Pure BULRIC.

Për sa i përket historikut më të gjatë të asimetrisë në vende të tjera, figura e mëposhtme paraqet asimetrinë e aplikuar në MTR në vendet evropiane më 1 Janar në periudhën 2009-2018, nga ku mund të vihet re se përqindja e asimetrisë e aplikuar në 8 vende ka qenë edhe më e lartë se 50% (rekomandimi i ERG) madje në katër vende edhe 100% deri afërsisht 300%.

**FIGURA 3.4: ASMITERIA E MTR NË VENDET EVROPIANE JANAR 2009-JANAR 2018**



Burimi: Cullen International (Dhjetor 2017)

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një variacion të madh të asimetrisë së aplikuar në 2009-2018 dhe diskutimi për asimetrinë e MTR dhe lidhjen me pjesët e tregut apo faktorë të tjerë që ndikojnë në racionalitetin e vendosjes së asimetrisë/simetrisë së MTR rezulton se është specifik për çdo vend dhe varet nga një sërë faktorësh të cituar edhe nga ERG (sot BEREC) në dokumentin *ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates*, ERG (07) 83 final 080312.

## 4. Rishikimi i tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri

---

Siç është evidentuar në seksionin e Hyrjes, AKEP (më parë ERT) përgjate viteve 2006-2016 ka përdorur një sërë mënyrash të rregullimit të tarifave në rrjetet celulare:

1. nëpërmjet procedurave të zgjidhjes se mos-marrëveshjeve duke përcaktuar çmime maksimale për tarifën e terminimit celular;
2. nëpërmjet statusit të FNT dhe rregullimit të nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, bazuar:
  - Në nivelet mesatare të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe/ose normës së ndryshimit të tyre;
  - Në rezultatet e modelit të kostove BULRAIC + të përgatitur në vitin 2010;
  - Në nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BURIC: viti 2014 e në vijim;
  - Në përdorimin e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) për të arritur në nivelin e synuar (benchmark ose kosto BULRAIC).

Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2014, në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër. AKEP në vitin 2014, në dokumentin dhe vendimet e Mars 2014 përllorarit nivelin e tarifës mesatare në vendet që kishin aplikuar BULRIC të pastër dhe kreu rregullime me glide path të tarifave të terminimit për të arritur nivelin benchmark të llogaritur. Gjatë kësaj periudhe numri i vendeve që kanë aplikuar modelin e kostove BULRIC i pastër është rritur nga 13 në vitin 2013 në 22 në vitin 2016, dhe 24 vende deri në Korrik 2017 si dhe 5 vende të tjera, si edhe Shqipëria rregullojnë tarifën e terminimit celular bazuar në tarifën benchmark të vendeve që aplikojnë modelin e kostove BULRAIC të pastër.

AKEP nëpërmjet vendimeve të Analizës së tregut në Nëntor 2014 rishikoi grafikun e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) të përcaktuar në Mars 2014, duke përshpejtuar arritjen e nivelit benchmark prej 1.48 lek/minute për Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

Ky përshpejtim u krye në kushtet e vendosjes së masave të tjera rregulluese për FNT, dhe sidomos për të adresuar problematikën e diskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net.

Detyrimet e vendosura për FNT në 2014 dhe rishikimi i tyre në Mars 2015 janë përshkruar në këtë dokument të analizës së tregut 2016, përfshirë efektin pozitiv në tregun me pakicë në lidhje me trafikun dhe tarifën e thirrjeve on-net/off-net, por edhe mos-dhënie efektesh në lidhje me pjesët e tregut.



AKEP vlerëson se këto efekte pozitive kanë ardhur si pasojë e zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net i shoqëruar me reduktime të ndjeshme të tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë.

## 1. Metoda e rregullimit të MTR

Sipas nenit 57 të ligjit 9918, Metoda e rregullimit të tarifave:

1. *AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:*
  - a) *Përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;*
  - b) *Korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:*
    - i) *kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;*
    - ii) *raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;*
    - iii) *procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;*
  - c) *përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.*
2. *Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:*
  - a) *praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;*
  - b) *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*
  - c) *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;*
  - d) *raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*
  - e) *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*
3. *Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.*
4. *Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.*
5. *AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.*

AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celularë është metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre, pra sipas pikës 1/a të nenit 57. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP gjykon si alternativë më të mirë përdorimin e tarifave benchmark dhe praktikave më të mira në vendet e BE dhe rajonit (BEREC-që përfshin vendet e BE si dhe disa vende të rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2.

## 1. *Benchmarku i përshtatshëm për MTR*

Në lidhje me zgjedhjen e mësipërme, AKEP në procedurën e këshillit publik vlerësoi se disa nga zgjedhjet kryesore që duhen bërë janë:

1. Përdorimi si *benchmark* i nivelit mesatar të MTR në vendet e BE (AVG EU 28) apo niveli mesatar i tarifave në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC;
2. Si referencë për nivelin benchmark të jetë niveli i MTR në vitin 2016 (sipas këshillimit publik në Dhjetor 2016) apo niveli benchmark i MTR në Korrik 2017 (përditësimi më i fundit në këtë dokument);
3. A duhet të përdoret ose jo *glide path* për të arritur në nivelin e synuar benchmark sipas zgjedhjeve në pikat 1 dhe 2 më sipër dhe a duhet të aplikohet tarifa simetrike apo asimetrike midis tre operatorëve celular dhe nëse po, si duhet të jetë skema/afatet e aplikimit të tyre.

Bazuar në përfundimet e analizës së tregut për FNT, impaktin e masave rregulluese të marra në Analizë të vitit 2014, problemet e evidentuara si dhe ndryshimet e ndodhura në treg, përfshirë impaktin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, impaktin e masave të tjera rregulluese për FNT të përshkruara në kapitullin e mëparshëm si dhe parimin e proporcionalitetit dhe promovimin e konkurrencës në treg dhe interesat e përdoruesve fundorë për një periudhë afatmesme-afatgjatë, AKEP gjykon sa më poshtë:

1. *Në lidhje me llojet e ndryshme të MTR mesatare në vendet e BE/BEREC, të përdoret tarifa mesatare e terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC.*

Kjo zgjedhje është në linjë me propozimin në këshillim publik në Dhjetor 2016 si dhe me praktikatat/vendimet e AKEP nga Mars 2014 e në vijim.

2. *Në lidhje vitin referencë për MTR benchmark në vendet BEREC, të përdoret tarifa mesatare e terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC deri në Korrik 2017, pra nivelin 0.8283 eurocent apo 1.11 lek/minutë, sipas kursit të këmbimit të përdorur nga BEREC në dokumentin BoR (17) 227 "Termination rates at European level-July 2017", publikuar më 7.12.2017.*

Kjo zgjedhje është në linjë me vendimet e mëparshme të AKEP ku ka përdorur informacionin më të fundit/të përditësuar të këtij *benchmarku*. Ndryshimi nga këshillimi publik në Dhjetor 2016 (propozimi 1.22 lek/minutë) është i arsyeshëm dhe proporcional pasi nga periudha e publikimit të dokumentit për këshillim publik në Dhjetor 2016 ka kaluar më shumë se një vit dhe gjatë periudhës Korrik 2016-Korrik 2017 tarifat mesatare (të shprehur në Lek) në vendet e BE/BEREC janë reduktuar me 9%-21%. Ndërkohë MTR mesatar në vendet e BEREC që kanë aplikuar Pure LRIC deri në Korrik 2017 është reduktuar me 21% në krahasim me Korrik 2013 që u morr si referencë nga AKEP për tarifën 1.48 lek/minutë që ka qëndruar e pandryshuar gjatë këtyre viteve në Shqipëri.

Në lidhje me përdorimin e metodës *benchmark* për tarifën mesatare të vendeve që kanë aplikuar BULRIC të pastër, AKEP ka sqaruar në dokumenta të tjerë tashmë arsyet e zgjedhjes së kësaj metode në raport me ndërtimin nga e para të një modeli BULRAIC të pastër në Shqipëri, si koha e gjatë e nevojshme për zhvillimin e modelit, burimet e kufizuara etj. Njëkohësisht që informacioni i dhënë nga operatorët për ndërtimin e modelit të jetë sa më i besueshëm, operatorët celularë duhet të zbatojnë ndarjen e llogarive dhe kosto korrente si bazë të kostove. Sic mund të vihet re dhe nga informacioni i paraqitur në Tabelën 3.1 të dokumentit, përvec Shqipërisë janë dhe 5 vende të BE/BEREC që aplikojnë metodën *benchmark* sipas tarifave mesatare në vendet që tashmë kanë ndërtuar modelet BULRAIC të pastër. Gjithashtu niveli i kostove BULRAIC i pastër i llogaritur në vende të ndryshme nuk ka ndryshime të mëdha nga njëri tjetri dhe niveli mesatar i tarifës së terminimit të këtyre vendeve është një nivel përfasues i mirë i kostove pavarësisht ndryshimeve midis vendeve pasi tashmë janë rreth 24 vende që përdorën për llogaritjen e mesatares së MTR.

Gjithsesi, AKEP do e ketë në vëmendje mundësinë për zhvillimin e një modeli BULRAIC të pastër për terminimin në rrjetet celularë krahas modelimit të kostove në rrjete fikse në vitet në vijim.

Në lidhje me alterantivat në pikën 3 më sipër, AKEP ka bërë arsyetimin dhe përcaktimet në seksionin në vijim.

## **2. Asimetria/Simetria dhe afati i aplikimit të MTR të ri**

Niveli i tarifës së terminimit prej 1.11 lek/minutë i përcaktuar nga AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit përbën një nivel të synuar (*target*) për tarifën e terminimit të tre operatorëve celularë në vitet në vijim.

Në lidhje me këtë nivel gjatë procesit të këshillimit publik u shtruan dy pyetje:

3. A duhet të aplikohen tarifa simetrike apo asimetrike midis operatorëve celularë?
4. Kur duhet të fillojë aplikimi i kësaj tarife dhe a është e nevojshme të aplikohet një *glide path* për të arritur në këtë nivel?

Një çështje e diskutuar në analizat dhe dokumentat e mëparshme të AKEP ka qënë aplikimi i tarifave asimetrike të terminimit midis operatorëve më të mëdhenj dhe të hershëm në treg në raport me operatorët më të vegjël dhe hyrës më të vonë në treg. Ecuria e tarifave të terminimit të dhënë në tabelën me poshte e evidenton asimetrinë e aplikuar ndër vite për Albtelecom (EM) dhe për Plus në raport me Vodafone Albania dhe Telekom Albania.



**TABELA 4.1: ASIMETRIA E TARIFAVE TË TERMINIMIT TË ALBTELECOM DHE PLUS**

	Albtelecom (EM)			Plus		
	%	Lek/minute	Muaj	%	Lek/minute	Muaj
<b>Mars 2008</b>	11%	1.75	6			
<b>Shtator 2008</b>	11%	1.37	12			
<b>Shtator 2009</b>	23%	2.42	14			
<b>Nentor 2010</b>	23%	2.42	4	80%	8.4	4
<b>Mars 2011</b>	23%	2.04	6	114%	10.05	6
<b>Shtator 2011</b>	17%	1.28	12	150%	11.33	12
<b>Shtator 2012</b>	7%	0.42	12	112%	6.82	12
<b>Shtator 2013</b>	0%	0	0	94%	4.28	7
<b>Prill 2014</b>	51%	1.34	8	145%	3.86	8
<b>Dhjetor 2014</b>	0%	0		341%	5.04	37
<b>Kohëzgjatje Total Asimetri</b>		74 muaj			86 muaj	

Kohëzgjatja totale e asimetrisë së Albtelecom (EM) ka qënë 74 muaj dhe niveli i asimetrisë së EM ka qënë 7-23% për rreth 5 vjet dhe 51% në për muaj në periudhën Prill-Nëntor 2014. Në terma mesatare të ponderuar (asimetri dhe muajt e aplikuar), niveli i asimetrise i aplikuar per Albtelecom ka qene mesatarisht 20% ose 1.54 lek/minute në muaj. Ndërkohë asimetria e aplikuar për Plus zgjati 86 muaj (7 vjet e dy muaj) apo mesatarisht 216% ose 6.5 lek/minutë në muaj.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut neto midis tre operatorëve celularë aktualë dhe pagesat neto midis tyre. Ne vijim të ndryshimeve në strukturën e tregut celular si dhe të komenteve të depozituara për këtë dokument, AKEP ka përditësuar të dhënat e grafikeve të publikuar në keshillim publik me muajt Janar-Gusht 2018 si më poshtë.

**FIGURA 4.1: EÇURIA E TRAFIKUT DHE TË ARDHURAVE NETO MIDIS TRE OPERATORËVE  
CELULARE 2014-18**



Në vijim të përfundimeve të analizave të tregut celular publikuar në Shkurt 2018 (tregu i terminimit dhe akses/origjinimit) si dhe të dhënave të mësipërme vihet re se:

5. Vodafone ka qenë përfitues neto në vlera të mëdha nga pagesat e interkoneksionit midis 3 MNO-ve;
6. Telekom Albania në 2014-2017 ka pasur të ardhura neto totale negative në vlerë të vogël, por këto të ardhura neto negative janë në rritje në vitin 2017 në raport me Vodafone për shkak të rritjes së trafikut off net drejt këtij operator;
7. Albtelecom ka qenë operatori që ka pasur të ardhura neto negative gjatë gjithë kohës së aktivitetit të tij, pavarësisht dhe asimetrisë së aplikuar, e cila vlen të theksohet se ka qenë më e ulët dhe se ato të rekomanduara nga ERG;
8. me daljen e sipërmarresit Plus Communications nga tregu ka ndryshime midis trafikut dhe të ardhurave/pagesave neto midis tre MNO-ve, por trendi vijon të jetë i njëjtë si në vitin 2017: Vodafone është përfitues neto, ndërsa Telekom dhe Albtelecom janë pagues neto.
9. Pësia e madhe e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në të ardhurat e operatorëve bën që dërrugullimi i MTR ndërkombëtar të krijojë avantazhe më të mëdha për operatorët më të mëdhenj në treg. Në vendet e BE ky nuk është problem pasi pësia e këtyre të ardhurave nga MTR ndërkombëtar jashtë rregullimit është shumë e vogël:
  - Thirrjet me të mëdha hyrëse ndërkombëtare janë midis vetë vendeve të BE që janë me MTR nën rregullim;
  - Normalisht vendet e zhvilluara (përfshirë ato të BE) janë vende që gjenerojnë shumë më tepër trafik dalës ndërkombëtar se hyrës ndërkombëtar nga vendet në zhvillim (si Shqipëri apo rajoni).
10. Nëse marrim në konsideratë MTR mesatare të ponderuar me trafikun (kombëtare dhe ndërkombëtare), atëherë ky MTR i ponderuar (3.92-4.94 lek/minutë) mund të konsiderohet jo i orientuar në kosto (1.11 apo edhe 1.48 lek/minutë);
11. Impakti i masave rregulluese, përfshirë nivelet e MTR nuk rezulton se kanë dhënë efekte në pjesët e tregut të operatorit më të madh në treg Vodafone duke çuar në rritje të HHI për shumë tregues.

### **Këshillimi Publik në Dhjetor 2016 dhe Shkurt 2018**

Nga komentet e tre operatorëve celularë për dokumentin e MTR të nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, vihet re se Vodafone dhe Telekom ishin kundër propozimit të AKEP për MTR=1.22 lek/minutë, pasi reduktimi nga niveli aktual prej 1.48 lek/minutë ndikon negativisht në të ardhurat dhe investimet e operatorëve celularë. Vodafone në komentet e Janar 2018 propozon që MTR 1.22 mund të hyjë në fuqi në gjysmën e dytë të vitit 2018 apo 1.09.2018 krahasuar me propozimin e parë të AKEP për 1.09.2017 (propozimi në këshillim publik nr.1 në Dhjetor 2016). Albtelecom në komentet finale në Janar 2018 ka propozuar aplikim asimetrie në MTR të Albtelecom me Vodafone dhe Telekom Albania. Bazuar në pjesët aktuale të tregut, dhe në qasjen lineare të lidhjes së MTR me pjesët e tregut, Albtelecom sugjeron që MTR të jetë 5.82

për Albtelecom, 3.82 për TA dhe 1.48 për VA. Albtelecom ka dërguar në rrugë elektronike dhe një dokument me sqarime në lidhje me percaktimin e MTR-se se operatoreve celulare bazuar në funksion linear dhe pjesët e tregut. Në këtë dokument Albtelecom sqaron se si mund të lidhen MTR me pjesët e tregut të operatorëve dhe duke marrë të dhënë MTR të Vodafone dhe të Plus dhe pjesët e tregut, shpjegon si ka arritur në vlerat e sugjeruara të MTR më sipër. Ndërkohë nëse përdoren pjesët e tregut të Tremujorit të 2-të 2017 të pajtimtarëve aktivë, Albtelecom sugjeron se MTR sipas formulës duhet të jenë 5.68 për Albtelecom, 3.28 për TA dhe 1.48 për VA.

Nderkohe komentet e paleve të interesuara për dokumentin e nxjerre në keshillim publik në Shkurt 2018, si dhe qëndrimi i AKEP për këto komente janë dhënë në Aneks 1 të këtij dokumenti.

### **Alternativat e propozuar për MTR në këshillim publik Shkurt 2018**

AKEP në vlerësimin për aplikimin ose jo të asimetrisë si dhe kohëzgjatjen dhe nivelin e saj ka marrë në konsideratë rekomandimet e KE dhe BEREC, dhe përvojën më të mirë në vendet e tjera për aplikimin e asimetrisë, dhe sidomos rekomandimet e dokumentit të ERG (sot BEREC): (*ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates, ERG (07) 83 final 080312*).

Për sa me sipër, si dhe bazuar në komentet e këshillimit publik për dokumentin e publikuar në 22.12.2016, AKEP në dokumentin e publikuar në Shkurt 2018 përfshiu një tabelë me disa alternativa të mundshme për MTR në 2-3 vitet në vijim, si më poshtë:

**TABELA 4.2: ALTERNATIVA PËR RREGULLIMIN E MTR**

Ref.	Alternativa	MTR (Alb/TA/VA)	Asimetria MTR Albtelecom/ Vodafone	Asimetria MTR Telekom/Vodafone
1	Simetri midis 3 MNO	1.48	-	-
2	Simetri midis 3 MNO	1.22	-	-
3	Simetri midis 3 MNO	1.11	-	-
4	Asimetri për Albtelecom	1.48/1.22	21%	
5	Asimetri për Albtelecom	1.48/1.11	33%	
6	Asimetri për Albtelecom	1.22/1.11	10%	
7	Asimetri për Albtelecom	2.66/1.48	80%	
8	Asimetri për Albtelecom dhe Telekom	1.48/1.22/1.11	33%	10%
9	Asimetri për Albtelecom dhe Telekom	2.66/1.48/1.22	118%	21%

Alternativa nr.1 është situata aktuale që është në fuqi nga 1.12.2014 për tre operatorët celularë. Vlerat e MTR në tabelë 1.11 dhe 1.22 janë benchmarku BULRIC i pastër, ndërsa 2.66 lek/minutë është faza e ndërmjetme e parashikuar nga AKEP për tu aplikuar për Plus (dhe për Albtelecom në 1.04.2015-1.01.2016 sipas Vendimeve të Mars 2014) për kalimin nga 4 lek/minutë në 1.48 lek/minutë. Kjo vlerë MTR (2.66 lek) është aplikuar dhe për Vodafone dhe Telekom Albania në periudhën 1.04.2014-1.12.2014.

AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik propozoi që MTR të rishikohen sipas tabelës së mëposhtme. Propozimi në këshillim publik përfshinte aplikimin e asimetrisë midis Albtelecom dhe Telekom dhe Vodafone.

**TABELA 4.3: PROPOZIMI I AKEP PËR MTR NË KËSHILLIM PUBLIK (SHKURT 2018)**

		Faza I	Faza II	Faza III	Faza IV
<b>Afati i Fillimit</b>	Aktualisht	1.05.2018- (ose sipas vendimit final të AKEP pas këshillimit)	1.05.2019	1.05.2020	1.11.2020-deri në një vendim tjetër të AKEP
<b>Ref.Alternativat</b>	<u>1</u>	<u>9</u>	<u>5</u>	<u>6</u>	<u>3</u>
<b>Vodafone Albania</b>	1.48	1.22	1.11	1.11	1.11
<b>Telekom Albania</b>	1.48	1.48	1.11	1.11	1.11
<b>Albtelecom</b>	1.48	2.66	1.48	1.22	1.11
<b>Asimetria</b>					
<b>Albtelecom v Vodafone</b>	0%	118%	33%	10%	0%
<b>Telecom v Vodafone</b>	0%	21%	0%	0%	0%

*Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH*

Propozimi për asimetri ishte një nga alternativat e propozuara në konsultimin publik dhe u bazua në disa argumenta, përfshirë trafikun jo-të balancuar midis tre operatorëve dhe pagesat neto midis tyre sa i përket termnimit të thirrjeve midis operatorëve.

Megjithatë bazuar në:

- Dokumentin e ERG (ERG 07 83 final 080312) i cili rekomandon se asimetria nuk është më e justifikuar kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
  - nuk ka më disbalanca të trafikut ose ato nuk vijnë për shkak të strategjive të operatoreve;
  - MTR-të e operatorëve të medhenj nuk janë shumë më të larta se kosto.
- Rekomandimin e KE për aplikim të modelit Pure LRIC dhe MTR simetrike.

*AKEP në këtë dokument final pas këshillimit publik ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë, si dhe uljen e mëtejshem të tyre për ti barazuar me benchmarkun më të fundit të MTR të vendeve të BEREC që kanë aplikuar model kostoje LRIC i pastër. Kjo është në përputhje dhe me objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC.*



Vlerat dhe afate e MTR finale sipas këtij dokumenti janë sipas tabelës së mëposhtëme:

**TABELA 4.4: PERCAKTIMI FINAL I AKEP PËR RISHIKIMIN E MTR (2018-2020)**

	Tarifa Aktuale	Faza I	Faza II
		1.12.2018	1.12.2019 (deri në një vendim tjetër të AKEP)
<b>Ref.Alternativat</b>	<b><u>1</u></b>	<b><u>2</u></b>	<b><u>3</u></b>
<b>Vodafone Albania</b>	<b>1.48</b>	<b>1.22</b>	<b>1.11</b>
<b>Telekom Albania</b>	<b>1.48</b>	<b>1.22</b>	<b>1.11</b>
<b>Albtelecom</b>	<b>1.48</b>	<b>1.22</b>	<b>1.11</b>

*Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH*

Për sa më sipër, vleresimi dhe propozimi i AKEP, bazuar në praktikat më të mira europiane dhe rekomandimet e BEREC (ERG), për nivelin e MTR është si më poshtë:

1. Niveli i synuar (target) për orientim në koston LRIC e pastës sipas nivelit benchmark të vendeve të BEREC që e kanë aplikuar këtë model kostoje të jetë 1.11 lek/minutë;
2. Për të arritur në këtë nivel të synuar, të aplikohet “*glide path*” me dy faza që fillojnë nga data 01.12.2018 dhe 01.12.2019;
3. Tarifat e terminimit të vijojnë të jenë simetrike midis tre operatorëve celularë;
4. MTR reduktohet në 1.22 lek/minutë në Fazën I dhe një vit më pas në Fazën II të reduktohet në 1.11 lek/minutë. Të dy këto vlera janë sa MTR mesatare e vendeve të BEREC që kanë aplikur LRIC të pastër në Korrik 2016 dhe Korrik 2017;

Reduktimet e MTR sipas vlerave dhe fazave të mësipërme si dhe vijimi i aplikimit të simetrisë midis tre MNO-ve është në linjë me rekomandimet e KE dhe BEREC dhe synojnë të rrisin konkurrencën midis tre operatorëve celularë, rritjen e stimujve për investime të këtyre sipërmarrësve në rrjete dhe shërbime celulare dhe përfundimisht dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve/përdoruesve fundore të këtyre shërbimeve në Shqipëri.

## 5. Efektet e ndryshimeve të MTR

---

AKEP në dokumentin e analizës së tregut ka evidentuar efektet positive në treg të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net si dhe të reduktimit të nivelit të tarifave MTR, të cilat për tre operatorët kryesore arritën nivelin 1.48 lek/minutë më 1.12.2014, sa niveli i tarifës mesatare në vendet e BEREC që kishin aplikuar modelin BULRIC i pastër deri në vitin 2013.

Në këtë dokument AKEP percaktoi për një reduktim të mëtejshëm të MTR të tre operatorëve nga niveli aktual 1.48 lek/minute në 1.22 lek/minutë më 1.12.2018 (që është sa niveli i tarifës mesatare në vendet e BEREC që kishin aplikuar modelin BULRIC i pastër deri në Korrik 2016), dhe më pas në 1.11 lek/minutë (që është sa niveli i tarifës mesatare në vendet e BEREC që kishin aplikuar modelin BULRIC i pastër deri në Korrik 2017). Këto nivele të reja përbëjnë një reduktim prej 18% në fazën e parë dhe me 9% në fazën e dytë dhe në total 25% reduktim nga niveli aktual.

Në vijim të reduktimeve të kryera më parë nga AKEP për MTR si dhe të zbatimit të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net, reduktimi i përcaktuar i MTR në këtë dokument gjykohet se do të japë një impuls shtese pozitiv në rritjen e mëtejshme të konkurrencës në tregun celular me pakicë në Shqipëri dhe përfitimeve të përdoruesve të shërbimeve celulare. Orientimi në koston LRIC të pastër gjykohet si një nga masat me efekt më të madh në rritjen e konkurrencës në treg dhe aftësisë konkurruese të operatorëve më të vëgjel nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve të tyre për thirrjet off-net. Reduktimet e MTR mund të cojnë në rënie të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare, por ato cojnë njëkohësisht në reduktim të kostove të thirrjeve off-net të operatorëve dhe mundësinë për tarifa më të lira të përdoruesve fundore, pra dhe në rritje të trafikut që mund të kompensojë për rënien e tarifës.

Formula<sup>9</sup> e mëposhtme paraqet mënyrën e llogaritjes së kostos mesatare të ponderuar për thirrjet dalëse (on-net dhe off-net) të një operatori celular.

***Kosto mesatare e një thirrje dalëse kombëtare drejt celularëve = ((proporcioni i thirrjeve on-net të MNO)x2xPureLRIC) + (proporcioni i thirrjeve off-net të MNO)x(PureLRIC + MTR që paguhet për off-net).***

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të kostove me shumicë të ponderuara sipas formulës së mësipërme duke u bazuar në proporcionin e trafikut të thirrjeve on-net dhe off-net të

---

<sup>9</sup> Nga dokumenti i OFCOM ' Mobile call termination market review 2015-18' (6 February 2015)

vitit 2017. Si bazë për koston Pure LRIC është marrë vlera 1.11 lek/minutë sa edhe MTR mesatar i vendeve të BEREC që kanë aplikuar Pure LRIC në 2017.

**TABELA 5.1: IMPAKTI I MTR NË KOSTOT ME SHUMICË TË THIRRJEVE CELULARE**

	<b>MTR (Plus) Alb/TA/VA</b>	<b>Vodafone Albania</b>	<b>Telekom Albania</b>	<b>Albtelecom</b>
<b>Viti 2017 4 MNO</b>	6.52/1.48/1.48/1.48	2.55	2.59	2.74
<b>Aktualisht 3 MNO</b>	1.48/1.48/1.48	2.33	2.38	2.48
<b>Faza I</b>	1.22/1.22/1.22	2.23	2.27	2.30
<b>Faza IV</b>	1.11/1.11/1.11	2.22	2.22	2.22
<b>Ndryshimi Faza I me Viti 2017 4 MNO</b>		-0.32	-0.32	-0.44
<b>Ndryshimi Faza I me Aktualen</b>		-0.1	-0.11	-0.18

*Shënim: Vlerat në lek/minutë pa TVSH*

Tabela tregon se kostot me shumicë të tre operatorëve reduktohen me 0.32-0.44 lek/minutë në krahasim me vitin 2017 dhe me 0.10-0.18 lek/minutë në krahasim me tarifat aktuale të MTR të tre operatorëve. Reduktimi i MTR pritet të sjellë dhe një situatë më të balancuar të pagesave neto midis tre operatorëve.

# Aneks 1: Komentet e këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP

---

AKEP me VKD Nr. 15 të datës 22.2.2018 miratoi publikimin e dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-Keshillim Publik 2*”. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP<sup>10</sup> dhe keshillimi publik u krye për një periudhë 30 ditore më 26.2.2018-28.3.2018.

Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komente palët e mëposhtëme të interesuara:

- Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën Nr. 155/1 Prot., datë 29.03.2018, (Referenca e AKEP nr. 2285/21, datë 05.04.2018);
- Albtelecom sh.a me shkresën Nr.2745, datë 28.03.2018, (Referenca e AKEP nr. 2285/18, datë 28.03.2018);
- Vodafone Albania sh.a me shkresën Nr. LEA/030/IL, datë 29.03.2018 (Referenca e AKEP nr. 2285/20, datë 29.03.2018);
- Telekom Albania sh.a me shkresën Nr.2166, datë 27.03.2018 (Referenca e AKEP nr. 2285/19, datë 29.03.2018).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces këshillimi për komentet dhe sugjerimet e dhena për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik.

Ky Aneks më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet:

Për orientim dokumenti më poshtë është stukturuar në këtë mënyrë:

## **I. Komentet të përgjithshme**

Kjo pjesë përmban komentet e dhëna nga palët e interesuara në përgjithësi për dokumentin, dhe jo në mënyrë specifike për pyetjet e këshillimit publik, si dhe qëndrimi i AKEP për këto komente të përgjithshme.

## **II. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik**

Kjo pjesë përmban komente e palëve të interesuara të grupuara sipas pyetjeve të këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP për komentet për çdo pyetje.

---

<sup>10</sup>[https://akep.al/images/stories/AKEP/publikime/2018/Rregullimi%20i%20tarifave%20te%20terminimit%20celulare%20MTR\\_%20Keshillim%20Publik%202018.pdf](https://akep.al/images/stories/AKEP/publikime/2018/Rregullimi%20i%20tarifave%20te%20terminimit%20celulare%20MTR_%20Keshillim%20Publik%202018.pdf)

## **I.1. Komente të përgjithshme dhe qëndrimi i AKEP**

### Komentet e Autoritetit të Konkurrencës

Në vijim të shkresës së AKEP Nr. 2285/16 Prot., datë 27.02.2018, Autoriteti i Konkurrencës mori në shqyrtim dokumentin "Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-Këshillim Publik 2", të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Vendimin Nr. 15, datë 22.02.2018.

Nga vlerësimi i analizës së tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, Autoriteti i Konkurrencës, ju paraqet komentet si vijon:

- Rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë dhe shprehemi dakord me propozimin që rregullimi i tarifave të terminimit të vijoje të rregullohet duke përdorur informacionin e përditësuar për vendet që kanë aplikuar modelin e kostove "Pure BU-LRIC" deri në vitin 2017.
- AKEP gjatë analizës së radhës të tregut të telefonisë celulare të fillojë aplikimin e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare sipas modelit Pure BU-LRIC.

Lidhur me aplikimin e tarifës asimetrike të MTR midis 3 (tre) ndërmarrjeve që operojnë në tregun e telefonisë celulare, vlerësojmë që AKEP në kuptim të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është organi rregullator ne fushën e komunikimeve elektronike, i cili kryen vlerësimet e kushteve të tregut dhe vendos lidhur me rregullimin e tarifave, përfshirë dhe asimetrinë e tyre, në respektim të një konkurrence të lirë dhe efektive në treg.

### Qëndrimi AKEP:

AKEP vlerëson kontributin e Autoritetit të Konkurrencës dhe dakordësinë për propozimin që "rregullimi i tarifave të terminimit të vijoje të rregullohet duke përdorur informacionin e përditësuar për vendet që kanë aplikuar modelin e kostove "Pure BU-LRIC" deri në vitin 2017".

### Komentet e Albtelecom

Në vijim të dokumentit të miratuar për këshillim publik "Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-Këshillim Publik 2", Albtelecom ka vlerësuar dhe konsideruar me shumë vëmendje këtë version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR-ve, i cili edhe sipas citimit të AKEP, merr në konsideratë ndryshimet e ndodhura në treg, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC së fundmi, si dhe komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018.

Lidhur me ndryshimet e ndodhura në treg, në këndvështrimin e Albtelecom, dalja nga tregu e operatorit PLUS Communication dhe kalimi i spektrit të frekuencave tek operatorët Vodafone dhe Telekom Albania u ofron këtyre operatorëve avantazhe të tilla të cilat qartazi do të ndikojnë në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të pjesëve të tyre të tregut, duke sjellë si pasojë potencialisht tkurrjen e fuqisë ndikuese për konkurrencën e ndershme të operatorit të tretë në treg. Ndërkohë që, Albtelecom mbetet operatori dukshëm me pjesën më të vogël të tregut dhe që i duhet të konkurrojë tani i vetëm kundrejt këtyre dy operatorëve dominantë tashmë të fuqizuar edhe më tepër me asetet më të fundit të frekuencave të marra nga PLUS.

Prandaj është e vlerësueshme rishikimi i tarifave të MTR-ve të operatorëve nga ana e AKEP edhe nga pikëpamja e pasurimit me sasinë e spektrit të perfituar nga kalimi i spektrit të frekuencave të operatorit PLUS drejt operatorëve Vodafone dhe Telekom. Kjo, edhe si një mekanizëm parandalues i praktikave të mundshme të subvencionimit të tërthortë dhe praktikave të tjera anti konkurruese nga fuqizimi i mëtejshëm nga asetet e frekuencave të marra, për më tepër në rrethanat e një operatori më pak në treg, çka qartësisht nuk është në të mirë të konkurrencës efektive.

Konkurrenca e Albtelecom, si i vetëm përballë dy operatorëve më të mëdhenj, bëhet akoma edhe më e vështirë, për shkak edhe të raportit të numrit të abonentëve të Albtelecom kundrejt dy operatorëve dominant, raport i cili në praktikën e njohur të kësaj industrie garanton rregullisht trafik hyrës në operatorët e mëdhenj gjithmonë më të lartë se në rrjetin e operatorit me pjesë tregu të vogël, ç'ka dhe është evidentuar nga AKEP qartazi në grafikët 4.1 dhe 4.2 në dokumentin e rregullimit të tarifave (fq.23 e dokumentit).

Për më tepër, nëse i referohemi të dhënave mbi balancën neto në pagesa mes operatorëve për vitet 2014-2017 (grafiku 4.2), vihet re një balancë e konsiderueshme negative për Albtelecom, e cila është e ndikuar jo vetëm prej raportit të numrit të abonentëve të Albtelecom krahasimisht me 2 operatorët e tjerë dominantë, por edhe për shkak të asimetrisë së ulët të tarifës së terminimit të Albtelecom me operatorët Vodafone dhe Telekom Albania (ish-AMC). Është lehtësisht i evidentueshëm fakti se kjo asimetri ka qënë që prej fillimit të aktivitetit të Albtelecom mobile (Eagle) shumë e ulët dhe më e vogël edhe se nivelet e asimetrisë së rekomanduar nga BEREC (ish-ERG).

Të ndodhur në këto kushte, në kontekst edhe të ndryshimeve më të fundit në treg, duke konsideruar veçanërisht avantazhet e dukshme që përfituan operatorët Vodafone dhe Telekom Albania në terma të pasurimit me asete/frekuenca nga realizimi i përqëndrimeve në tregun e telefonisë celulare, Albtelecom gjykon se:

- në kuadër të mbrojtjes dhe nxitjes së konkurrencës së ndershme,
- si dhe, në kuadër të parimit të proporcionalitetit në vendosjen e detyrimeve rregullatore,

niveli i asimetrisë dhe vlerat e tarifave të terminimit të propozuar nga AKEP janë të pamjaftueshme dhe nuk arrijnë plotësisht masën e proporcionalitetit për operatorin më të vogël në raport me problemet komplekse dhe evidente të konkurrencës në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri.

Konsideruar rrethanat e paraqitura më sipër, Altelecom gjykon gjithashtu se, propozimi i AKEP për tarifën e terminimit të Altelecom dhe niveli i asimetrisë së tarifave në raport me tarifat e terminimit të operatorëve Vodafone dhe Telekom Albania, është i pamjaftueshëm edhe për të adresuar problematikat e evidentuara në treg.

Kështu:

- në kushtet e një imbalance trafiku rregullisht negative për Altelecom (figura 4.1, fq 23 e dokumentit të AKEP),
- në kushtet e trajtimit të Altelecom Mobile (Eagle) me një nivel asimetrie ndër vite më të ulët krahasuar me atë të rekomanduar nga BEREC (ish-ERG),
- në kushtet e trajtimit me asimetri shumë më të ulët se sa niveli i asimetrisë të aplikuar ndër vite për operatorin Plus (i cili ka përfituar edhe 340% asimetri për rreth 3 vjet).
- në kushtet e kalimit të spektrit të frekuencave të Plus tek operatorët Vodafone dhe Telekom Albania duke fuqizuar edhe më shumë ndikimin e tyre në këtë treg, dhe për më tepër,
- kur edhe pa patur këto asete shtesë , dy operatorët Vodafone dhe Telekom Albania zotërojnë mbi 80% pjesë tregu qoftë në të ardhura dhe qoftë në numër pajtimtarësh;

është plotësisht e legjitimuar kërkesa e Altelecom, se përtej niveleve të asimetrisë të propozuara nga AKEP, bazuar në gjetjet dhe evidentimet konkrete nga vetë AKEP në dokumentin për keshllim publik- 2, kjo asimetri duhet të jetë më e lartë dhe sipas nivelit të kërkuar nga Altelecom me shkresën nr.263, dt.12.01.2018 dërguar AKEP, duke iu referuar përcaktimit të nivelit të tarifave bazuar në qasjen lineare, proporcionalisht me pjesët e tregut të operatorëve në treg, sikurse dhe është argumentuar dhe është trajtuar në komentet tona dërguar me shkresën e sipërpërmendur si dhe me materialin sqarues "Përcaktimi i MTR -ve me funksion linear bazuar në market shares" dërguar elektronikisht në vijim të komenteve në dt.29.01.2018.

## Qëndrimi AKEP

AKEP sqaron se niveli i propozuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka si qëllim realizimin e objektivave rregullatore të promovimit të konkurrencës së ndershme dhe rritjen e përfitimeve të përdoruesve fundorë, bazuar në parimin e proporcionalitetit që masat rregulluese të adresojnë problemet e identifikuara në treg, përfshirë zhvillimet e tregut celular në vitin 2017 dhe pritshmëritë për të ardhmen, pas daljes nga tregu të operatorit Plus Communication.

## Komentet e Telekom Albania

Shoqëria Telekom Albania vlerëson vendimin e AKEP për këshillimin publik, "*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete celulare*".

TA e konsideron të domosdoshëm vlerësimin e situatës aktuale që po kalon sektori i komunikimeve elektronike në Shqipëri, e në veçanti ai i telefonisë së lëvizshme duke theksuar se, AKEP në analizat e tij si dhe në vendimet e tij për masat rregullatore kundrejt tregut të komunikimeve celulare duhet të evidentojë më qartë shkaqet e rënies së të ardhurave dhe masat rregullatore kundrejt operatorëve duhet të jenë proporcionale dhe të konsiderojnë në mënyrë të veçantë rëndësinë e një konkurrence të ndershme në treg dhe perspektivën e investimeve dhe modernizimin e shërbimeve për përdoruesit. Telekom Albania gjykon se AKEP në analizën e tregut të shërbimeve celulare, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare, duhet të marrë në konsideratë korrelacionin e situatës të ndarjes së tregut celular në Shqipëri po ashtu edhe ekzistencën e operatorëve që ofrojnë shërbime të integruara.

Bazuar në legjislacionin e BE-së, më specifiku në Udhëzimin e Komisionit Europian 2002/C 165/03 si dhe praktikat rregullatore, kriteri bazë i mjaftueshëm për përcaktimin e statusit me FNT të një operatori në treg është pjesa e lartë në nivelin mbi 40% që ai zotëron i vetëm në tregun e marrë në shqyrtim, pasi është një tregues i rëndësishëm që evidenton probleme eventuale të konkurrencës në këtë treg. Mbi këtë bazë duhet të përcaktohen më pas dhe masat rregullatore përkatëse për këtë operator për të adresuar problemet e konkurrencës që lindin nga pozicioni i tij dominant në treg, të cilat duhet të jenë proporcionale me pjesët e tregut që ky operator zotëron.

Në situatën në të cilën AKEP ka analizuar tregun e shitjes me pakicë të operatorëve celularë (sipas dokumentit të analizës së tregut miratuar me VKD nr.16, dt.22.02.2018) dhe ka propozuar që detyrimet për mos diskriminim të tarifave/volumeve on-net/off-net të vazhdojnë për TA dhe në kushtet kur ky treg impaktohet nga niveli i MTR, këshillimi publik për rregullimin e tarifave të terminimit nga ana e AKEP nuk duhet trajtuar si një çështje e ndarë në një analizë të veçantë por duhet konsideruar dhe trajtuar së bashku me analizën e tregut të shitjes me pakicë, pasi masat rregullatore që përcaktohen në mënyrë të veçantë për këto dy tregje janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe nuk duhen parë si të veçuara midis tyre pasi efektet e masave rregulluese të tyre në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë janë kumulative dhe progresive.

Telekom Albania gjykon se një çështje tjetër që duhet marrë në konsideratë nga AKEP në këtë këshillim publik për rregullimin e tarifave të terminimit është dhe analiza e avantazheve që gëzon një operator për shkak të operimit të tij jo vetëm në tregun e komunikimeve celulare por dhe në tregje të tjera, pasi këto avantazhe, që operatorët e tjerë nuk i kanë, transferohen dhe shtrihen dhe në tregun e marrë në analizë për shkak të operimit të tij si një operator i integruar.



Në këtë pjesë të dytë të këshillimit publik AKEP ka prezantuar metodologjinë e përdorur për rregullimin e MTR-ve si dhe është propozuar *glidepath i ri i MTR* për secilin nga operatorët celularë. Për rregullimin e MTR-ve është rimarrë në shqyrtim metodologjia benchmark e cila në përcaktimin e MTR merr për referencë vlerën mesatare të tarifave të terminimit të vendeve të BEREC që kanë aplikuar BU LRIC të pastër.

AKEP në *glidepathin* e ri të MTR-ve ka propozuar gjithashtu rifutjen e niveleve të asimetrisë midis tre operatorëve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom respektivisht në 21% midis TA dhe VDF gjatë fazës së parë dhe në nivelet 80%, 33% dhe 10% gjatë fazave I, II dhe III midis TA dhe Albtelecom si dhe aplikimin e tarifës së re simetrike për të gjithë operatorët në nivelin 1.11 lekë/min sipas metodologjisë benchmark të tarifave mesatare të vendeve të BEREC me LRIC të pastër duke filluar nga data 1.11.2020.

Është evidente se AKEP vazhdon të përdorë metodologjinë *benchmark* sipas tarifave mesatare të vendeve të BEREC për tarifatat e terminimit në rrjetet celulare dhe si dhe aplikimin e vlerave të reja të tarifave të terminimit sipas *glide-pathit* të propozuar.

MTR-të e propozuara nuk janë të bazuara në një model të saktë kostosh siç parashikohet nga ligji për komunikimet elektronike dhe legjislacioni i BE-së (Rekomandimi i vitit 2009 për trajtimin e tarifave të terminimit fiks dhe celular). Bazuar në nenet 45,49 dhe 57 e në vijim të ligjit 9918 të komunikimeve elektronike tarifatat duhet të jenë të orientuara në kosto.

MTR-të e prodhuara në bazë të një modeli kostoje do të ishte mënyra më e mirë për përcaktimin e nivelit të tyre, në mënyrë për të eliminuar impaktet negative në financat e operatorëve, planet e biznesit etj. Për më tepër mënyra e përcaktimit me *benchmark* i tarifave të terminimit nuk merr parasysh nivelin e konsiderueshëm të investimeve në rrjetet celulare të bëra gjatë dy viteve të fundit siç janë, marrja e licensave në brezat e frekuencave 1800 MHz dhe 2600 MHz dhe lancimi i teknologjisë 4G, apo investimet e pritshme që do të bëhen nga operatorët pas tenderit publik për brezin 800 MHz që pritet së shpejti nga ana e operatorëve.

*Propozimi i AKEP për rikthimin e asimetrisë së tarifave të terminimit duhet të konsiderojë dhe të mbështetet në parimin e mos-diskriminimit dhe të proporcionalitetit të detyrimeve rregullatore për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive.*

TA thekson faktin se në bazë të analizave që kanë bërë nivelet e asimetrisë të *tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP kanë një impakt negativ për shoqërinë Telekom Albania* si për vitin 2018 ashtu edhe për vitin 2019 duke shkaktuar një pasiguri të operimit në treg për investime të mëtejshme për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara, çka konsiderohen të pa pranueshme në kontekstin e të gjithë faktorëve dhe rrethanave në treg, si dhe të pa mbështetur e të pa justifikuar nga pikëpamja e qëllimit të rregullimit të tregut.

## Qëndrimi AKEP

AKEP sqaron se parimi i rregullimit të tarifave është i bazuar në parashikimet e neni 57.1 (Metoda e rregullimit të tarifave) nr. 9918, datë 19.5.2008(i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikë 2 të këtij neni, në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

- a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
- b) tarifatat mesatare të vendeve të BE-së;
- c) tarifatat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;
- d) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
- e) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e Besë dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

Sipas pikës 3 të këtij neni, metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.

Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2014, në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër. AKEP në vitin 2014, në dokumentin dhe vendimet e Mars 2014 për llogaritë nivelin e tarifës mesatare në vendet që kishin aplikuar BULRIC të pastër dhe kreu rregullime me *glide path* të tarifave të terminimit për të arritur nivelin benchmark të llogaritur.

Ashtu siç është sqaruar në dokumentin për këshillim publik, në lidhje me përdorimin e metodës benchmark për tarifën mesatare të vendeve që kanë aplikuar BULRIC të pastër, AKEP ka sqaruar në dokumenta të tjerë tashmë arsyet e zgjedhjes së kësaj metode në raport me ndërtimin nga e para të një modeli BULRAIC të pastër në Shqipëri, si koha e gjatë e nevojshme për zhvillimin e modelit, burimet e kufizuara etj. Njëkohësisht që informacioni i dhënë nga operatorët për ndërtimin e modelit të jetë sa më i besueshëm, operatorët celularë duhet të zbatojnë ndarjen e llogarive dhe kosto korrente si bazë të kostove.

Siç mund të vihet re dhe nga informacioni i paraqitur në Tabelën 3.1 të dokumentit, përveç Shqipërisë janë dhe 5 vende të BE/BEREC që aplikojnë metodën benchmark sipas tarifave mesatare në vendet që tashmë kanë ndërtuar modelet BULRAIC të pastër. Gjithashtu niveli i kostove BULRAIC i pastër i llogaritur në vende të ndryshme nuk ka ndryshime të mëdha nga njëri tjetri dhe niveli mesatar i tarifës së terminimit të këtyre vendeve është një nivel përfasues i mirë i kostove pavarësisht ndryshimeve midis vendeve pasi tashmë janë rreth 24 vende që përdoren për llogaritjen e mesatares së MTR.

Gjithsesi, AKEP do e ketë në vëmendje mundësinë për zhvillimin e një modeli BULRAIC të pastër për terminimin në rrjetet celulare krahas modelimit të kostove në rrjete fikse në vitet në vijim.

## Komentet e Vodafone Albania

Vodafone Albania pasi u njoh me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 15, datë 22.02.2018 "Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Këshillim Publik 2", paraqet më poshtë në Aneksin 1 komentet dhe qëndrimin e tij me qëllim që të kontribuojë në funksionimin e tregut përkatës në mënyrë sa më efektive bazuar në konkurrencën e drejtë.

Rregullimi i tarifave të terminimit në rrjetet celulare është një çështje thelbësore pasi kushtëzon strukturën e industrisë, strukturën e çmimeve dhe rrjedhimisht nivelin e konsumit në tregjet celulare në terma afatshkurtër dhe afatgjatë. Ky rregullim do të ketë një impakt të rëndësishëm te konsumatorët por edhe në performancën më të gjerë ekonomike në nivel kombëtar duke qenë se komunikimet celulare janë një lehtësues i rëndësishëm në pjesëmarrjen dhe produktivitetin shoqëror.

Për këtë arsye kuadri ligjor i brendshëm dhe evropian kërkon që natyra dhe justifikimi i masave rregullatore t'i nënshtrohet një procesi transparent konsultimi dhe e vendos përgjegjësinë mbi autoritetin rregullator për të shqyrtuar dhe vlerësuar haptazi nëse një masë rregullatore e propozuar për kontrollin e çmimeve promovon efikasitetin, konkurrencën e qendrueshme dhe maksimizon përfitimet e konsumatorit.

Përpara se të shqyrtoni komentet në Aneksin 1 më poshtë, Vodafone dëshiron të theksojë faktin që aktiviteti jonë tregtar varet tej mase nga rezultatet e këtij këshillimi dhe për këtë arsye kërkojmë që shqetësimet e mëposhtme të adresohen nga AKEP. Vodafone dëshiron të theksojë që po i dorëzon këto komente në mirëbesim dhe me të vetmin qëllim për të ndihmuar AKEP në përmirësimin e rregullimit të komunikimeve elektronike në Shqipëri duke përfituar aktorët në treg, në qendrueshmërinë e konkurrencës së shëndoshë afatgjatë dhe në vazhdimin e rritjes së standardit të jetesës për shqiptarët. Si një pjesë e pandashme e ambjentit konkurrues në territorin shqiptar dhe si një nga kontribuesit më të mëdhenj të konkurrencës së drejtë në tregun e komunikimeve elektronike dhe në përgjithësi në ekonomi. Vodafone ndihet i detyruar të nbrojë qëndrueshmërinë e tij në treg përmes këtyre komenteve në këtë këshillim publik, duke qenë se është operatori që do të vuante më shumë pasojat në rast zbatimi të këtyre masave rregullatore sipas dokumentit për këshillim.

Në fakt Vodafone ka arsye për të besuar që këto masa të propozuara do të pengojnë si përfundim investimet në tregun e komunikimeve elektronike, siç është detajuar në disa pjesë të përgjigjes sonë më poshtë, çka nuk do të sjellë asnjë përfitim afatshkurtër apo afatgjatë për konsumatorin.

Ndërkohë Vodafone pas komenteve sipas pyetjeve të këshillimit publik ka dhënë dhe komente shtesë si më poshtë:

Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në 2006 me shtetet anëtare të BE dhe në 2014 ka fituar statusin kandidat. Prandaj, Shqipëria ka marrë angazhime zyrtare për të përfruar kuadrin e saj ligjor me BE-në dhe për të ndjekur praktikën më të mirë të kësaj të fundit.

Megjithatë, këto veprime të AKEP-it shkelin dispozitat kyçe të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si ato të nenit 71 për konkurrencën *“çdo ndihmë shtetërore që shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara, është e papajtueshme me zbatimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje”*. Për më tepër, neni 104 mbi komunikimet elektronike parashikon që *“Palët në veçanti, të forcojnë bashkëpunimin në fushën e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve shoqëruese, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Shqipëria të acquis të Komunitetit në këto sektorë një vit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje”*. Neni 50 i MSA në paragrafin 2 parashikon se *“Palët nuk do të miratojnë asnjë rregullore ose masa të reja që do të sillnin diskriminim në lidhje me themelimin e ndërmarrjeve të vendeve anëtare të BE ose shqiptare në territorin e tyre ose në lidhje me funksionimin e tyre, pas themelimit në krahasim me shoqëritë e tyre”*.

Në fund, VA dënon këtë trajtim diskriminues nga AKEP-i, ku ky i fundit, me një sjellje totalisht të njëanshme krahasuar me analizën e tregut fiks (por me të njëjtin qëllim, vendosjen e Albtelecom në një pozicion të avantazhuar në mënyrë arbitrare), redukton MTR-të dhe zbaton asimetri në pa asnjë përlllogaritje të bazuar në kosto dhe asnjë justifikim të përshtatshëm objektiv sipas rekomandimit të Komisionit Evropian. Ne vazhdojmë të këmbëngulim, se AKEP-i, si organi rregullator, duhet të jetë i paanshëm në qasjen dhe trajtimin e tij ndaj të gjithë aktorëve në treg dhe qëllimi i tij duhet të jetë promovimi i konkurrencës së drejtë në tregun e komunikimeve elektronike sipas nenit 7 të ligjit. Është e papranueshme që AKEP-i të zbatojë standarde të dyfishta duke favorizuar Albtelecom dhe duke diskriminuar aktorët e tjerë si në tregun e telefonisë fikse dhe asaj celulare, duke shkelur haptazi parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimin të barabartë të operatorëve siç, është përcaktuar qartë në kuadrin e zbatueshëm ligjor shqiptar dhe të BE-së.

Ne çdo rast ri-aplikimi i asimetrisë në favor të Albtelecom është në kontrast të plotë me praktikën evropiane dhe legjislacionin e BE-së për një sërë arsyes:

- a) Albtelecom është i vetmi operator i përfshirë në tregun e telekomunikacionit që përfiton nga ndër-subvencionimi midis dy tregjeve fikse dhe mobile në të cilat ai vepron dhe për të cilin AKEP nuk shfaq kurrfarë interesi edhe pse Albtelecom i nënshtrohet ndarjes kontabël;
- b) Albtelecom ka një pozitë të qartë mbizotëruese në tregun e telefonisë fikse duke kaluar 71%;
- c) Pjesa e tregut të ardhurave të kombinuara i Albtelecom është mbi 20%;
- d) Albtelecom është prezent në tregun shqiptar për një periudhë më të gjatë se konkurrentët e tij. Një shoqëri që vepron prej më shumë se 20 vitesh në tregun e telekomunikacionit

dhe prej 10 vitesh në atë celular, nuk mund të trajtohet nga AKEP-i si një hyrës i ri në asnjë lloj rrethane.

Albtelecom ka përfituar nga asimetria në të shkuarën, gjë e cila e pengoi nga shndërrimi në një operator eficient dhe është duke kërkuar përsëri asimetrinë në dëm të konsumatorëve dhe konkurrentëve të tij në tregjet fikse dhe ato celulare.

Këto qasje të paarsyeshme kundrejt të dy tregjeve në favor të Albtelecom, shkelin detyrime kyçe ligjore dhe konsiderohen si diskriminuese dhe të rrezikshme për konkurrencën, në vend që ta ndihmojnë atë; zbatimi i hapur i këtyre masave në favor të një pale, konsiderohet si ndihmë shtetërore dhe ndalohet si nga kuadri i brendshëm ligjor dhe nga ai evropian.

#### Qëndrim AKEP:

AKEP sqaron se në përputhje me nenin 7 të ligjit “Për komunikimet elektronike” i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Europian dhe BEREC-it.

Duke shprehur dakordësinë për rëndësinë e masave rregullatore, AKEP ka zhvilluar analizën e tregut në funksion të rregullimit të konkurrencës në tregjet që justifikojnë rregullimin dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar duke patur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e BE për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

AKEP sqaron Vodafone Albania se është e drejtë legjitime e AKEP rregullimi i tarifave sipas nenit 53 e në vijim të Ligjit dhe se rregullimi i tarifave nuk ka asnjë lidhje me ligjin Nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” (Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009, nr. 21/2016, datë 10.3.2016). Sipas nenit 4 të këtij ligji, format e ndihmës shtetërore përfshijnë kryesisht:

- a) grantet dhe subvencionet;
- b) përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;
- c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;
- d) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;
- e) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta;
- f) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
- g) uljen e çmimit të produkteve të ofruara, shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;
- h) zmadhimin e kapitalit shtetëror të ndërmarrjet ose ndryshimin e vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat, që vepron në kushte ekonomike normale.

Duket qartë se metodologjia e miratimit të tarifave të termnimit të thirjeve në rrjetet celulare nuk ka asnjë lidhje me klasifikimet e ndihmës shtetërore të cituara si më lart.

Gjithashtu, sqarojmë se AKEP nuk ka miratuar asnjë rregullore të re por është mbështetur tërësisht mbi parimet e Ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” për Rregullimin e Konkurrencës(Kreu VI), përcaktimin e tregjeve përkatëse (neni 32), sipërmarrësit me fuqi të

ndjeshme në treg(neni 33), analizën e tregut(neni 34), këshillimin public(neni 35), bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës dhe zbatimin e rregullimit të tarifave(neni 56 e në vijim) si dhe rregullores nr. 9, datë 17.7.2009 “Për anaizën e tregut”( VKD NR.747, 17.07.2009, ndryshuar me VKD NR.2342, DATE 31.07.2013).

Siç është sqaruar në faqen 22 e në vijim të dokumentit, kohëzgjatja totale e asimetrisë së Albtelecom (EM) ka qënë 74 muaj dhe niveli i asimetrisë së EM ka qënë 7-23% për rreth 5 vjet dhe 51% në për 8 muaj në periudhën Prill-Nëntor 2014. Ndërkohë asimetria e aplikuar për Plus zgjati 86 muaj (7 vjet e dy muaj) apo mesatarisht 216% në muaj ose 6.5 lek/minutë.

AKEP në vleresimin e tarifave të reja të terminimit ka marrë në konsideratë rekomandimet e KE dhe BEREC, dhe përvojën më të mirë në vendet e tjera dhe sidomos rekomandimet e dokumentit të ERG (sot BEREC): *(ERG’s Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates, ERG (07) 83 final 080312)*.

AKEP në këtë dokument final pas këshillimit publik ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë, dhe uljen e tyre bazuar në objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC-it.

## **II.2. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP**

### **1. A janë pasqyruar drejt tarifat *benchmark* të vendeve të BE dhe BEREC për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare dhe përditësimi i tyre deri në Korrik 2017 në Seksionin 3?**

Telekom Albania

Siç jemi shprehur dhe në konsultimin publik nr.1, të Dhjetor 2017 - Janar 2018, dokumenti i BEREC për nivelin e tarifave të terminimit për vendet që bëjnë pjesë në të (vendet anëtare të BE, vendet e zonës europiane ekonomike, si dhe vendet candidate në BE, përfshirë dhe Shqipërinë) është një dokument i rëndësishëm që shërben si burim informacioni për analizat e tregut nga autoritetet rregullatore në këto vende lidhur me nivelin e tarifave të terminimit si për telefoninë fikse ashtu dhe për atë të telefonisë celulare, për këtë arsye dhe AKEP, ashtu si dhe rregullatorët e tjerë përkatës, mund të përdorë në konsultimet publike dokumentat e publikuara periodikisht nga BEREC për tarifat e terminimit si burim krahasues.

Për sa i përket pasqyrimit të këtyre të dhënave, TA nuk ka ndonjë objeksion apo koment shtesë për të shtuar për sa referuar nga AKEP për tarifat benchmark të BE dhe BEREC dhe përditësimin të këtij informacioni.

TA rithekson dhe një herë që për përcaktimin e tarifave të terminimit celular në vendin tonë nuk mund të merret si referencë ky informacion i BEREC, pasi vendet që janë pjesë e këtij organizmi karakterizohen nga nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik (vendet anëtare të BE-së dhe të rajonit), me hendeq të theksuar të standarteve ekonomike, e cila përfshin dhe situatën në sektorin e komunikimeve elektronike dhe kjo reflektohet dhe në nivelin përkatës të tarifave të terminimit, pasi dhe kostot e infrastrukturës dhe më gjerë të sektorit (përfshirë dhe kostot përkatëse të shërbimeve të telefonisë) që manifestojnë operatorët e telefonisë celulare në Shqipëri nuk janë të njëjta me ato të operatorëve në një vend të BE-së, duke qenë se tarifat e terminimit janë tarifa që i reflektojnë këto kosto, siç parashikohet dhe në kuadrin rregullator vendas apo dhe atë të BE-së për përcaktimin e tyre sipas parimit të tarifave të orientuara në kosto.

Vodafone Albania

Komisioni Europian ka rekomanduar Autoritetet Rregullatore të sigurojnë që tarifat të zbatohen në një nivel kostoje eficientë dhe simetrike. Në kontekstin e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve dhe duke pasur parasysh veçanërisht karakteristikat dhe problemet e konkurrencës dhe të shpërndarjes që lidhen me to, tarifa e koston efiçente normalisht është ajo që rezulton nga një

metodologji BU-LRIC<sup>11</sup> e "pastër". Kjo për arsye se modeli BU-LRIC ofron sinjalin e duhur të kostos te operatorët në mënyrë që të rrisin efikasitetin si dhe kontribuon në shmangien e shtrembërimit të konkurrencës.

Komisioni Europian konsideron që metodat alternative si benchmark të mund të aplikohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht për shkak të burimeve të kufizuara (i cili sigurisht nuk është rasti i Shqipërisë, kur Autoriteti Rregullator nuk është në gjendje të finalizojë modelin "pure" BU-LRIC të kostos dhe kur Autoriteti Rregullator është në gjendje të provojë që rezultatet e metodologjisë së zgjedhur përputhen me Rekomandimin mbi Tarifat e Terminimit dhe me ato në një treg konkurrues. Pas korrikut të 2014, një Autoritet Rregullator që aplikon benchmarking duhet të provojë që zhvillimi i një modeli të duhur kostoje është objektivisht jo proporcional.

AKEP ka pasqyruar drejtë tarifat sipas dokumenteve të BEREC dhe përditësimit të tyre deri në raportin e fundit të korrikut 2017. Megjithatë, edhe njëherë Vodafone shfaq shqetësimin e tij për sa i përket metodës së kryerjes së këtyre analizave. Në vend që të kryhet një analizë e përshtatshme dhe të përdoret një proces metodologjik kostoje, në përputhje me kuadrin rregullator, AKEP vazhdon të zbatojë një metode të vjetëruar dhe të papërshtatshme (për MTR-të dhe FTR-të) si benchmarking.

## Qëndrim i AKEP

AKEP vëren se Telekom Albania dhe Vodafone shprehen se AKEP ka pasqyruar drejt tarifat benchmark sipas dokumenteve të BE/BEREC ndërkohë që çështje e kontestuar mbetet metodologjia e zgjedhur benchmark në vend të Pure Liric.

Ashtu siç është sqaruar në dokumentin për këshillim publik, në lidhje me përdorimin e metodës benchmark për tarifën mesatare të vendeve që kanë aplikuar BULRIC të pastër, AKEP ka sqaruar në dokumenta të tjerë tashmë arsyet e zgjedhjes së kësaj metode në raport me ndërtimin nga e para të një modeli BULRAIC të pastër në Shqipëri, si koha e gjatë e nevojshme për zhvillimin e modelit, burimet e kufizuara etj. Njëkohësisht që informacioni i dhënë nga operatorët për ndërtimin e modelit të jetë sa më i besueshëm, operatorët celularë duhet të zbatojnë ndarjen e llogarive dhe kosto korrente si bazë të kostove.

Siç mund të vihet re dhe nga informacioni i paraqitur në Tabelën 3.1 të dokumentit, përveç Shqipërisë janë dhe 5 vende të BE/BEREC që aplikojnë metodën benchmark sipas tarifave mesatare në vendet që tashmë kanë ndërtuar modelet BULRAIC të pastër. Gjithashtu niveli i kostove BULRAIC të pastër i llogaritur në vende të ndryshme nuk ka ndryshime të mëdha nga njëri tjetri dhe niveli mesatar i tarifës së terminimit të këtyre vendeve është një nivel përfasues i mirë i kostove pavarësisht ndryshimeve midis vendeve pasi tashmë janë rreth 24 vende që përdoren për llogaritjen e mesatares së MTR.

---

<sup>11</sup> Bottom Up Long-Run Incremental Cost është një model i bazuar në kostot aktuale që reflekton kostot e një operatori eficient



**2. A jeni dakort me propozimin e AKEP për aplikimin e metodës së përcaktimit të çmimit maksimal duke përdorur informacionin për tarifatat në vendet e tjera (BE dhe BEREC), pra me tarifa benchmark?**

Telekom Albania

Si edhe në komentet e mëparshme për këtë çështje, Telekom Albania ka qenë kundër kthimit të aplikimit të metodës sipas tarifave benchmark, propozuar që në analizën e tregut të vitit 2014. Edhe në ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 45, 49 dhe 57 parashikohet qartësisht kërkesa për zbatimin e parimit të orientimit të tarifave drejt kostos dhe preferencën për një model të saktë të kalkulimit të kostove përkatëse krahasuar me metodat sipas tarifave benchmark.

Për më tepër, dhe nga informacioni i ilustruar në dokumentet e BEREC për tarifatat e terminimit, shumë vendeve fqinj dhe shtetet anëtare të BE-së kanë implementuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave të terminimit celular të bazuar në kosto, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe në asnjë nga këto vende nuk hasen praktika të rikthimit të kontrollit dhe përcaktimit të tarifave nga metodologjitë LRIC në atë sipas tarifave benchmark, siç ka ndodhur me AKEP, i cili gjatë gjithë kësaj periudhe kohore i ka pasur të gjitha burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të filluar ndërtimin dhe aplikimin e një modeli për llogaritjen e kostove të terminimit dhe përcaktimin e tarifave përkatëse.

Siç evidenton dhe vetë AKEP në faqen nr.14 të dokumentit për këshillim publik, bazuar në raportimet periodike të BEREC që nga Korriku i vitit 2016 dhe deri në raportimin e fundit për Korrik 2017, numri i vendeve që aplikojnë modelin LRIC të pastër ka shkuar nga 21 në 24, i cili është gjithmonë në rritje. Pra, të gjitha vendet e BE dhe BEREC kanë tendencën drejt aplikimit të plotë të modelit LRIC të pastër, siç e kërkon dhe Rekomandimi i KE-së i vitit 2009 për trajtimin e tarifave të terminimit fiks dhe celular.

Telekom Albania nënvizon faktin se përdorimi i metodave sipas tarifave benchmark për caktimin e çmimit maksimal shkakton devijime materiale në llogaritjen e kostove reale të operatorëve, duke qenë se llogaritjet që rezultojnë nga aplikimi i një modeli kostosh janë të dhëna më korrekte pasi reflektojnë saktësisht kostot që manifestojnë operatorët celularë në ofrimin e shërbimit të terminimit.

Aplikimi i metodave benchmark ka impakt për sa i përket pozitive financiare të operatorëve dhe planeve të tyre të biznesit në terma afatgjatë, pasi nuk reflektojnë kostot dhe investimet e kryera të operatorëve dhe për rrjedhojë të normës së kthimit të këtyre investimeve.

Përsa mësipër, mbështur dhe në pozicionet e saj të mëparshme, Telekom Albania mban të njëjtin qëndrim kundrejt propozimit të AKEP për aplikimin e metodës së përcaktimit të çmimit

maksimal duke përdorur tarifën benchmark të vendeve të tjera (BE dhe BEREC), dhe vlerëson se metoda më e saktë dhe e duhur është ndërtimi i një metodologjie për përlogaritjen e kostove për përcaktimin e tarifave maksimale të bazuara në këto kosto, siç e kërkon kuadri rregullator BE-së dhe ai në vendin tonë.

Vodafone Albania

Jo. Ashtu si Vodafone është shprehur gjithmonë, e vetmja mënyrë për të përcaktuar tarifën e terminimit është përmes një analize të bazuar në kosto dhe zhvillimit të metodologjisë përkatëse. Prandaj, AKEP duhet të zbatojë një model të bazuar në kosto sipas veçorive të tregut të operatorëve shqiptarë dhe të karakteristikave specifike të tregut shqiptar. Benchmarking duhet të jetë vetëm një metodë e përkohshme dhe alternative ndaj asaj të bazuar në kosto; por, AKEP e ka kthyer benchmarking në të vetmen alternativë, pranë një rregull për çdo analizë. Kjo është e dëmshme për tregun dhe konkurrencën, pasi në terma afatgjate, operatorët nuk duhet të tarifojnë në bazë të modeleve ekonomike të zhvilluara në vende të tjera me karakteristika të ndryshme nga ato të tregut dhe operatorëve shqiptarë.

Vodafone beson që tarifën e orientuar ndaj koston dhe sigurisht simetrike, do të përmirësojnë konkurrencën, largojnë inefiçencën në treg, sjellin tarifën më të ulët për përdoruesit fundorë dhe si rrjedhim shmangin nevojën për të ndërhyrë me masa rregullatore në tregun e pakicës si trafiku on-net/off-net. Në çdo rast, AKEP duhet të ketë gjithmonë parasysh ndikimin e tarifave dhe të ruajë ekuilibrin midis çdo reduktimi të këtyre tarifave dhe investimeve strategjike që garantojnë një infrastrukturë më të mirë, inovacion dhe kohëzgjatje të zhvillimit.

**Qëndrimi AKEP:**

Ashtu siç kemi diskutuar në dokument dhe në përgjigjet e komenteve më sipër, AKEP po vlerëson marrjen e asistencës së duhur teknike për mundësimin e një modeli BULRAIC të pastër për terminimin në rrjetet celulare, krahas modelimit të kostove në rrjetet fikse për ta zbatuar në raundin e ardhshëm të analizave të tregjeve përkatëse.

**3. A jeni dakort që AKEP duhet të vazhdojë të përdorë si benchmark tarifën mesatare të terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër (pure LRIC)?**

Telekom Albania

Aplikimi i një modeli për përlogaritjen e kostove për tarifën e terminimit parashikohet në kuadrin rregullator të BE, dhe më specifikisht në Rekomandimin e Komisionit Europian të vitit 2009, në pikën 2.

Në piken 12 të Rekomandimit të KE-së 2009/396/EC, përcaktohet se vetëm në raste të veçanta, për shkak të burimeve të kufizuara, autoriteti rregullator mund të përdori një metodologji alternative (siç është metoda benchmark) dhe vetëm në rastet kur është në gjendje dhe ka paraqitur evidenca që kjo metodologji alternative jep rezultate efikente në përputhje me ato të një tregu konkurrues, gjë për të cilën AKEP nuk ka dhënë informacione në mënyrë që të justifikojë aplikimin e metodës benchmark.

AKEP nuk ka sjellje asnjë lloj evidence apo të dhënë lidhur me kostot e nevojshme për ndërtimin e nje modeli për kalkulimin e kostove të terminimit apo shpjegim mbi pamundësinë e ndërtimit të tij, kur ndërkohë e ka kryer një praktikë të tillë më parë (në vitin 2010 për ndërtimin e modelit BULRAIC në përcaktimin e tarifave të terminimit), dhe në gjithë këtë periudhë kohore i ka pasur të gjitha burimet njerëzore dhe financiare për studimin dhe implementimin e një modeli të tillë duke marrë në konsideratë të gjithë periudhën kohore që nga viti 2010 i implementimit të metodologjisë BULRAIC e deri më sot, apo të ardhurat që AKEP ka mbledhur dhe merr në mënyrë periodike nga operatorët për licensat, përdorimin e frekuencave, mbikqyrjen e tregut, etj.

Pra, nuk ka argumentime apo fakte dhe rrethana bindëse që justifikojnë vazhdimin e përdorimit të tarifës mesatare të terminimit të vendeve BEREC me BULRIC të pastër dhe se pse nuk duhet të aplikohet një model kostoje siç është LRIC i parashikuar në Rekomandime KE-së.

Gjithashtu, karakteristikat e ndryshme të tregut të telefonisë së lëvizshme në Shqipëri krahasuar me ato të vendeve të BEREC (të cilat përfshijnë shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e rajonit) të cilat kanë nivele të ndryshme të zhvillimit dhe standarteve ekonomike, bëjnë që përdorimi i metodologjisë benchmark sipas tarifave të këtyre vendeve të çojë në përfundime jo të sakta pasi nuk mund të merren si referencë krahasimore vende pa asnjë ngjashmëri mes tyre në përcaktimin e tarifave të terminimit në tregun celular.

Në pozicionet e saj në konsultimet e mëparshme publike lidhur me aplikimin e metodës së përcaktimit të çmimit maksimal sipas informacionit për tarifën në vendet e tjera (BE dhe BEREC), pra me tarifa benchmark, Telekom Albania është shprehur kundër aplikimit të metodës sipas tarifave benchmark, e propozuar në analizat e fundit të tregut të kryera nga AKEP nga viti 2014 e në vazhdim, duke kërkuar aplikimin e metodologjisë BULRAIC si bazë për përllogaritjen e tarifave të terminimit të telefonisë celulare dhe asaj fikse.

Në këto kushte, Telekom Albania gjykon se AKEP nuk duhet të vazhdojë të përdorë si benchmark tarifën mesatare të terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin BULRIC të pastër, por të zhvillojë një model kostoje BULRIC.

Vodafone Albania

Jo. Ashtu si më lart dhe sipas kuadrit rregullator të brendshëm dhe atij evropian- përkatësisht rekomandimi i Komisionit Evropian i 7 majit 2009 - deri më 31 dhjetor 2012:

- Autoritetet Rregullatore duhet të caktojnë tarifatat e terminimit të thirrjeve zanore në bazë të kostove të një operatori eficient;
- MTR duhet të jenë simetrike;
- Vlerësimi i kostove eficientë duhet të bazohet në kostot aktuale dhe në përdorimin e një modeli të kostove afatgjata inkrementale nga poshtë-lart (BU-LRIC) "të pastër" duke ndjekur parimet e përcaktuara në rekomandim.

Duke qenë se standardi përkatës i kostos për vendosjen e tarifave të terminimit duhet të jetë BU-LRIC, i cili pasqyron koston e një operatori eficient në parim nuk duhet të ketë asimetri midis tarifës së operatorit/(ëve) që ushtrojnë aktivitetet prej kohësh dhe tarifatat e atyre që kanë hyrë me vonë në treg<sup>12</sup>. Kjo përputhet gjerësisht me Qëndrimin e Përbashkët të ERG-së për simetrinë<sup>13</sup> i cili deklaron se tarifatat e terminimit normalisht duhet të jenë simetrike dhe që asimetria duhet të jetë e justifikuar si duhet.

I njëjti arsyetim përdoret nga AKEP gjatë analizës, ku veçanërisht seksioni 3 i referohet kërkesave të sipërpërmendura. Megjithatë, çuditërisht ai zbaton një metodë tjetër për përcaktimin e MTR-ve, gjë që sjell çorientim dhe le vend për masa arbitrare.

Përveç kësaj, ligji shqiptar nr. 9918/2008 ka miratuar të njëjtën qasje, ku në të gjithë nenet që rregullojnë tarifatat, ai specifikon detyrimin e orientimit ndaj kostos. Për shembull në nenin 45 kërkohet që operatorët FNT të orientojnë tarifatat drejt kostove për aksesin dhe/ose interkoneksionin dhe gjatë shqyrtimit të këtyre masave, duhet marrë parasysh gjithashtu investimi i kryer nga operatori, duke lënë një normë të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar, përfshirë edhe riskun. Përveç kësaj, në nenin 53 kërkohet që kur operatorët përcaktojnë tarifatat, duhet t'i orientojnë ato drejt kostos; duke shmangur kështu tarifatat abuzive dhe antikonkurrese. Qëllimi i rregullimit të tarifave është shmangia e çdo sjellje antikonkurrese dhe e diskriminimit të përdoruesve fundorë dhe konkurrentëve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e operatorëve FNT.

Gjithashtu, sipas nenit 55, gjatë rregullimit të tarifave, AKEP merr parasysh mbrojtjen e interesave të operatorit tarifatat e të cilit janë objekt i rregullimit në mënyrë që tarifatat që do të rezultojnë nga vendimi i AKEP-it të jenë të orientuara drejt kostos.

E njëjta gjë është theksuar në nenet 56 dhe 57 dhe e gjithë kjo sipas parimeve kryesore të parashikuara në nenin 7 të ligjit ku nën titullin "Objektivat rregullatore" deklarohet se "AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve

<sup>12</sup> Dokumenti i punës së stafit të Komisionit që shoqëron Rekomandimin e Komisionit në Trajtimin Rregullator të tarifave të Terminimit në telefoninë celulare dhe fikse në BE (shenim shpjegues)

<sup>13</sup> Qëndrimi i Përbashkët i ERG-së mbi simetrinë e tarifave të terminimit të thirrjeve fikse dhe simetrinë e terminimit të thirrjeve mobile)

elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-it. AKEP-i nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera, ndër të tjera, për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Përveç kësaj, relacioni shpjegues i Rekomandimit të 2009 parashikon arsyetimin që qëndron mbrapa për vendosjen e çmimeve të bazuara në kosto. Relacioni parashikon se në kuadër të mundësisë dhe incentivave që kanë operatorët e terminimit për të rritur çmimet në mënyrë të konsiderueshme mbi koston, orientimi drejt koston është ndërhyrja më e përshtatshme për të adresuar këtë problem në terma afat-mesëm. Orientimi drejt koston adreson si problemet e efiçencës së prodhimit dhe ato të alokimit. Nga perspektiva e produktivitet-efikasitetit tarifave të ulëta të terminimit lehtësojnë uljen e tarifave të thirrjeve me pakicë dhe rritjen e konsumit. Është gjithashtu me rëndësi që çmimi përkatës të bazohet mbi koston e një operatori efiçent. Nëse rregullimi i tarifave të terminimit bazohet mbi koston reale të operatorit kjo nuk do të sigurojë incentivat e duhura për operatorët që ata të sjellin risi dhe të rrisin efiçencën. Pasi mungesa e këtij të fundit do të mbulohej nga konkurrentët e tyre. Kjo do të sjellë gjithashtu probleme të natyrës efiçencës alokuese meqë klientët e operatorëve të tjere do të bartnin koston e operatorëve jo efiçentë.

Me fjalë të tjera, modeli që është zbatuar prej kaq kohësh nga AKEP-i, jo vetëm nuk adreson problemet më lart, por duke zbatuar një benchmark dhe duke aplikuar asimetri në mënyrë arbitrare, AKEP-i është duke vënë në rrezik operatorët e efiçentë, për të mbuluar mungesën e efiçencës së një operatori dhe duke i futur ata në vështirësi me synimin për t'i shndërruar nga të shëndetshëm në jo efiçentë.

Efiçenca alokative kërkon që një grup klientësh nuk duhet të subvencionojnë një grup tjetër klientësh. Përveç ndërsubvencionimit fiks-mobile që e theksuam edhe në analizën e tregut të telefonisë fikse, kjo ka rëndësi edhe brenda tregjeve (në këtë rast tregjeve celulare).

## Qëndrimi i AKEP

Komisioni Evropian, BEREC në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, ka rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre).

Komisioni Evropian në rekomandimin më të fundit për orientimin në koston të tarifave të terminimit, Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC), ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave se vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli koston LRIC të

pastër mund të përdorin metodën benchmark duke i'u referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.

BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC.

Në listen e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC, në kohën e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit për MTR nga AKEP në Dhjetor 2016 ishte dokumenti BoR (16) 218 "*Termination rates at European level-July 2016*", i cili paraqet situatën e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 Korrik 2016.

Dokumenti i BEREC përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit përmban informacion të detajuar edhe për tarifën e terminimit sipas operatorëve në çdo vend dhe metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe '*glide path*' të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.

**4. A jeni dakort me nivelin e propozuar të MTR 1.11lek/minutë dhe cili është afati më i arsyeshëm për fillimin e aplikimit të tarifës së re nga secili prej tre operatorëve celularë?**

Albtelecom sh.a

*Lidhur me glide-path e tarifave të terminimit të propozuar nga AKEP, propozimi i AKEP për aplikimin e tarifave simetrike nga 01.11.2020 apo edhe pretendimet e palëve të interesit kundër asimetrisë së propozuar nga Albtelecom, duke iu referuar edhe përcaktimeve apo udhëzimeve të Direktivave të Komisionit Europian, është i nxituar dhe i parakohshëm për Albtelecom në kushtet dhe rrethanat që nuk është ende e qartë se si tregu do të "shërohet" nga problematikat e mëdha që është përballur dhe po përballlet aktualisht.*

Rekomandimet dhe Direktiva e Komisionit Europian për simetri të tarifave të terminimit kanë vend dhe janë aplikuar vetëm pasi masat rregullatore kanë dhënë efektet e tyre pozitive dhe kur të dhënat dhe niveli i konkurrencës në treg kanë treguar për nivele optimale të konkurrencës. Vetëm pasi janë krijuar këto kushte, autoritetet rregullatore kanë aplikuar përcaktimin e tarifave të terminimit simetrike si masë rregullatore parandaluese për të ruajtur nivelin e konkurrencës efektive.

Gjithashtu, edhe për sa i përket nivelit konkret të tarifave të terminimit, krahasimi me vendet e tjera do mund të bëhet "*ceteris paribus*" (gjithë të tjerat njësoj) në rrethanat që edhe tregu i

komunikimeve elektronike në vendet respektive me të cilët bëhet krahasimi, do kishte të njëjtit nivel të indikatorëve të tregut me treguesit e tregut të komunikimeve elektronike në vendin tonë.

Dëshmi e qartë se aplikimi simetrik i tarifave të terminimit nuk mund të aplikohet apriori thjesht si zbatim i rekomandimeve të KE pa konsideruar edhe rrethana të tjera, është rasti i dështimit për dhënien e efekteve të synuara në treg, me kalimin e menjëhershëm me tarifë simetrike për Albtelecom në vlerën 1.48 lek/min (Nëntor 2014) njësoj si për operatorët dominantë, pavarësisht pjesës së tij të vogël të tregut, e aplikuar kjo në mënyrë të njëkohshme me detyrimin e mosdiskriminimit on-net/off-net edhe për Albtelecom. Në të kundërt të efekteve të pritura, me aplikimin e këtyre masave njëherazi edhe për operatorin me pjesë tregu të vogël, operatori dominant vetëm sa forcoi më tej pozitën e tij dominuese dhe Albtelecom ka vijuar të jetë net payer (pagues neto) me vlera të konsiderueshme ndaj Vodafone dhe Telekom.

Aktualisht në Shqipëri, situata nuk tregon për konkurrencë efektive dhe aq më pak për kushte optimale të saj, ndërkohë që dalja nga tregu e operatorit të katërt është sinjal i fortë alarmi për cënimin e konkurrencës dhe mosfunksionimin eficient të saj. Përkeqësimi i situatës së konkurrencës në tregun e telefonisë së lëvizshme është evidentuar qartë edhe në Vendimet e Autoritetit të Konkurrencës nr. 484 dhe nr. 483 dt. 23.11.2017, ku vërehet se përqëndrimi i tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri është ende i lartë për të gjithë treguesit e tij në vlera që arrijnë në 4 089 pikë. HHI e lartë, si indikator që tregon përqëndrimin e tregut, është evidentuar edhe në dokumentin për këshillim publik-2 për rregullimin e tarifave të terminimit, fq. 24 si dhe në dokumentin e publikuar për këshillim publik për tregun e akses origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare, fq. 34.

Në këto rrethana, është detyrë për çdo Autoritet Rregullator që, në përmbushje të objektivave të përcaktuara nga Ligji, të marrë masat për rregullimin e duhur në masën që kërkon korrigjimi i problemit të evidentuar për arritjen e një konkurrence efektive. Kjo për më tepër, në kushtet kur masat rregullatore të aplikuar deri tani kanë dështuar për arritjen e një konkurrence efektive dhe kur gjithashtu kanë kontribuar që një operator të dalë nga tregu dhe operatori i tretë (Albtelecom) të vijojë duke u rënduar me pagesa neto negative në interkoneksion, ndërkohë që dy operatorët dominantë vijojnë forcimin e pozitës së tyre dominuese dhe rritjen e pjesëve të tregut.

## Telekom Albania

Telekom Albania nuk është dakord me nivelin e propozuar të MTR 1.11 lekë/min, ashtu siç është shprehur kundër nivelit të MTR 1.22 lekë/min dhe në pjesën e parë të konsultimit publik për rregullimin e MTR-ve. Aplikimi i vlerës 1.11 lekë/min së pari përbën një reduktim të konsiderueshëm prej 37% nga niveli aktual i tarifës së terminimit (1,48lekë/min), i cili do të ketë një efekt negativ në financat dhe planet e investimit të kompanive, veçanërisht duke marrë në konsideratë investimet e konsiderueshme në rrjet nga Telekom Albania, si në marrjen e brezave

të frekuencave në 1800 MHz dhe 2600 MHz, apo në teknologjinë 4G, si dhe në investimet e pritshme që do të pasojnë pas tenderit për brezin 800 Mhz që pritet të organizohet në një të ardhme të afërt nga AKEP, por dhe trendin në rënie të vazhdueshme të të ardhurave të operatorëve në sektorin e telefonisë celulare. Pra, ky propozim për një reduktim të mëtejshëm të tarifës së terminimit nga ana e AKEP nuk u mundëson operatorëve rekuperimin e kostove të investimeve, duke ulur mëtej aftësinë konkurruese të operatorëve në treg në ofrimin e produkteve/shërbimeve sipas pritshmërisë dhe nevojave të abonentëve.

Niveli i vlerës së MTR 1,11 lekë/min nuk reflekton koston reale të operatorëve dhe nuk është i mbështetur mbi bazën e një përlllogaritjeje të saktë sipas një modeli të kostove, por është një vlerë arbitrare që ka si referencë krahasuese vende më të zhvilluara pjesë e BEREC me një nivel më të lartë të zhvillimit ekonomik krahasuar me vendin tonë, dhe jo mesatarja e tarifave të terminimit të vendeve të rajonit duke qenë se kanë një nivel të ngjashëm të zhvillimit ekonomik, kulturor, etj.

Bazuar në dokumentin e BEREC "BoR (17) 227 Termination rates at European level July 2017", nga përlllogaritja e mesatares së MTR-ve për periudhën 1.07.2017-31.12.2017 të disa vendeve të rajonit (Greqi, Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mai i Zi) rezulton se kjo mesatare është në nivelin 1,087 eurocent/min ose 1.46 lekë/min, pra më e lartë se sa ajo e propozuar nga AKEP 1.11 lekë/min si mesatare referuar vendeve të BEREC me LRIC të pastër.

Niveli i lartë i konkurrencës dhe i maturitetit të tregut të telefonisë celulare, ulja e vazhdueshme e treguesve financiarë të operatorëve celularë, shkalla e lartë e investimeve në rrjet dhe në teknologji, ulja e tarifave në tregun me pakicë, ka sjellë një ulje të konsiderueshme të të ardhurave dhe fitimeve gjatë këtyre viteve të fundit. Për rrjedhojë ky reduktim i mëtejshëm i tarifave të terminimit prej 37% nga niveli aktual i tarifave do të inpaktojë akoma më negativisht pozitativat financiare në treg të operatorëve celularë dhe dëmton planet e tyre afatgjata të biznesit dhe të investimeve të nevojshme për t'u kryer në të ardhmen. Për arsye të këtyre faktorëve Telekom Albania nuk është dakord me nivelin e tarifës së terminimit 1.11 lekë/min të propozuar nga AKEP.

Për sa i përket datës së fillimit të aplikimit të tarifës së re, TA gjykon AKEP duhet të implementojë një model të kostove për përcaktimin e tarifave të reja të terminimit të operatorëve.

#### Vodafone Albania

Së pari, Vodafone është kundër reduktimit të MTR-ve në nivelin e 1.22 lek/min brenda vitit 2018. Vodafone kërkon që një reduktim i tillë nga 1.48 në 1.22 lek/min të nisë duke filluar nga data 1 janar 2019. Reduktimi i MTR-ve duke nisur nga 1 janari do të ishte më i natyrshëm dhe gjithashtu në linjë me tarifën mesatare të vendeve të BEREC që AKEP-i përdor si referencë. Vodafone ka qenë gjithnjë kundër çdo reduktimi të menjëhershëm të tarifave të terminimit (p.sh. brenda 2018 si në këtë rast) pasi kjo përbën një rrezik real për qëndrueshmërinë financiare të operatorëve në treg dhe do të ndikonte negativisht në nivelin e investimeve.



Së dyti, "Glide Path" ose reduktimi gradual i tarifave zbatohet nga organet rregullatore në mënyrë që operatorët të rregullojnë modelet e tyre të biznesit, nivelet e reja të çmimeve dhe gjithashtu të garantojnë që operatorët të mos kalojnë një "shok" për shkak të reduktimit të ndjeshëm të tarifave që mund të shkaktojë luhajtje të çmimeve, të të ardhurave të shoqërive dhe si pasojë të qëndrueshmërisë së tyre financiare. "Glide Paths" gjithashtu ndihmojnë organet rregullatore për të ekuilibruar përfitimet afatshkurtra të konsumatorëve kundrejt mbrojtjes së nxitësve të investimit. Në këtë aspekt shumica e organeve rregullatore janë të ndjeshme ndaj riskut mbi investimin (të cilat janë kryesisht të planifikuara sipas planeve shumëvjeçare) për shkak të reduktimeve drastike, të menjëhershme ose të përsëritura të tarifave të rregulluara. Në këtë kontekst do të ishte pa kuptim që t'u kërkohej operatorëve të vazhdonin me kryerjen e investimeve të reja, kur të ardhurat janë ulur në mënyrë drastike, madje deri në nivelin kur rezultatet e fitimeve janë në shifra negative; edhe më shumë kur marrim parasysh faktin që Vodafone është investitori më i madh. I kujtojmë AKEP-it që Vodafone sapo ka investuar në blerjen e spektrit të Plus Communication dhe pritet gjithashtu të investojë dhe më tej në shfrytëzimin e tij. Përveç kësaj, AKEP-i ka lançuar një këshillim publik për dhënien e të drejtave të shfrytëzimit për brezin e frekuencave 800 MHz(790-862), duke u bërë thirrje të gjithë operatorëve që të shfaqin interes dhe të ofrojnë shumën përkatëse të investimit që duan të kryejnë. Prandaj, kjo situatë është surreale dhe çdo ndërhyrje ndaj MTR-ve në këtë moment të rëndësishëm, (pa llogaritur asimetrinë) do të rrezikonte qëndrueshmërinë e planit të buxhetit dhe do të ishte në drejtim plotësisht të kundërt me investimet e parashikuara.

Gjithashtu, përveç dispozitave të nenit 45 të ligjit nr. 9918/2008 në lidhje me vlerësimin e riskut të investimit që duhet të kryhet nga AKEP-i, nëse ky i fundit zbaton MTR jashtëzakonisht të ulta pa analizën e përshtatshme, do të pengonte Vodafone që të ndërmernte investime infrastrukturore dhe inovative në të ardhmen. Vodafone mendon që ky rregullim është kundër qëllimit të Komisionit Evropian ku në nenin 3, paragrafi 3 të Direktivës Kuadër parashikon se një Autoritet Rregullator duhet të:

- *"mbrojtë konkurrencën në dobi të konsumatorëve dhe promovojë, sipas rastit konkurrencën e bazuar në infrastrukture" dhe "promovojë investimin eficient dhe inovacionin në infrastruktura të reja dhe të përmirësuarra, duke përfshirë garantimin që çdo detyrim aksesit të marrë mjaftueshëm në konsideratë riskun e ndërmarrjeve investuese dhe duke lejuar disa marreveshje bashkëpunimi midis investitorëve dhe palëve që kërkojnë akses për të diversifikuar riskun e investimit duke garantuar ruajtjen e konkurrencës në treg dhe parimin e mosdiskriminimit".*

Përveç kësaj, neni 13, paragrafi 1 i Direktivës së Aksesit deklaron se autoritetet rregullatore kombëtare marrin parasysh investimet e bëra nga operatori dhe i lejojnë atij një përqindje të arsyeshme vjetore mbi investime për kapitalin e perdorur duke marrë parasysh risqet e përfshira.

Nga ana tjetër, në rastin e analizës së tregut për telefoninë fikse AKEP-i ka një qasje tjetër dhe në kundërshtim me atë që ka për MTR-të. Më poshtë disa pjesë nga analiza e tregut të telefonisë fikse:

*Ulja e FTR [...] përbën një reduktim jo-proporcional dhe që nuk i shërben promovimit të investimeve në infrastrukturë të rrjeteve fikse (telefoni dhe broadband) në Shqipëri, si dhe objektivave rregullatore në Ligjin 99181...]*

*[...] përbën një reduktim të konsiderueshëm të kësaj tarife (46%) nga niveli aktual për të gjithë operatorët e rrjeteve fikse dhe në kushtet specifike të Shqipërisë për rrjetet fikse (shumë rrjete fikse dhe në madhësi shumë më të vogël se vendet e BE-së, pra me ekonomi shkalle shumë të kufizuar)*

*Më tej: /.../ AKEP gjykon që së pari nëpërmjet nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit të analizës së tregut që miratohet me këtë vendim, njëkohësisht të vendosë të shtyjë aplikimin e reduktimit të parashikuar më 1.01.2018 për tarifën e terminimit (të të gjithë operatorëve të rrjeteve fikse) dhe tranzitimit të Altelecom, duke vijuar me tarifën aktuale deri në afatin (dhe vlerat) që do përcaktohen në vendimet përkatëse që AKEP do të marrë për FNT dhe masat rregulluese pas këshillimit publik të dokumentit të miratuar me këtë vendim.*

Si më lart, përveç shqetësimeve të ngritura mbi zbatimin e benchmarkut në vend të vendosjes së çmimeve të bazuara në kosto, ne kërkojmë nga AKEP të ketë të njëjtën qasje si për tregun e telefonisë fikse përse i përket uljes së përshkallëzuar për MTR.

## Qendrimi i AKEP

Në lidhje me komentet e Altelecom, AKEP thekson se skema e re e MTR është bazuar në një sere faktoresh, të cituar në këtë dokument, dhe që ka si objektive kryesore realizimin e objektivave të ligjit 9918 për rritje të stimujve për investime në rrjete të komunikimeve elektronike, konkurrencës në treg dhe përfundimisht përfitimeve në periudhë afatmesme-afatgjatë për përdoruesit fundorë të tyre nga rritja e investimeve dhe konkurrencës në treg.

Në lidhje me komentet e Telekom Albania dhe Vodafone Albania, se nivelet 1.22 apo 1.11 lek/minutë nuk janë nivelet e duhura dhe të arsyeshme për tregun në Shqipëri, AKEP sqaron se ka dhënë përgjigje në këtë dokument dhe në qendrimin ndaj komentve të përgjithshme, duke theksuar njëkohësisht se niveli 1.22 lek/minutë është propozuar nga AKEP që në Dhjetor 2016 në dokumentin e parë të këshillimit publik për MTR, duke propozuar datën 1.09.2017 për hyrjen në fuqi të saj.

## 5. A jeni dakort me propozimin e AKEP për asimetrinë e MTR për Albtelecom në raport me dy operatorët e tjerë?

Albtelecom sh.a

Ne besojmë se qasja lineare për MTR-të është një opsion i arsyeshëm për të përcaktuar tarifa asimetrike për operatorët. Për më tepër, rishikimi i MTR-së duke aplikuar asimetrinë e propozuar nga Albtelecom është i rëndësishëm për të siguruar proporcionalitetin e pjesëve të tregut për secilin operator të tregut.

Lidhur me kërkesën për nivelin e asimetrisë së kërkuar nga Albtelecom, na lejoni të sjellim në vëmendje edhe dy elementë të tjerë të rëndësishëm:

Tarifat asimetrike në nivelin e kërkuar nga Albtelecom, të aplikuara bashkë edhe me masa të tjera rregullatore, janë domosdoshmëri rregullatore për të ndaluar apo parandaluar mundësitë operatorëve dominantë për subvencionim të tërthortë nëpërmjet të ardhurave nga tarifat e terminimit duke aplikuar në nivel pakice të çmimeve grabitqare "predatory price" apo çmimeve pa-arsyeshmërisht të ulta, të njohura ndryshe në praktikën ndërkombëtare si rabate-ve ("rebates"), duke përfituar nga pozita dominante në tregun e komunikimeve elektronike, siç mund të jetë rasti i Vodafone Albania apo edhe së bashku me Telekom Albania në dominancë të bashkuar.

Ndërkohë, Albtelecom si operatori më i vogël me pjesë tregu, të paktën 3 herë më pak se Vodafone, e ka të pamundur objektivisht t'i kundërpërgjigjet konkurrencës me operatorët dominantë apo të ndjekë këto praktika tregtare, jo vetëm për shkak të pafuqisë financiare por edhe për shkak të pagesave të mëdha në interkoneksion ndaj Vodafone dhe Telekom Albania si rrjedhojë e bilancit negativ për trafikun e shkëmbyer që Albtelecom ka kryer ndër vite ndaj këtyre dy operatorëve dominantë në tregun e komunikimeve elektronike, të evidentuara edhe nga vetë AKEP.

Pagesat negative në vite të Albtelecom, demostrojnë qartë që mënyra dhe masa jo proporcionale e rregullimit të tarifave të MTR-ve ndër vite, ka sjellë rëndimin e konsiderueshëm financiar të Albtelecom, i cili megjithëse më i vogli "të ushqejë" me pagesa nga interkoneksioni dy operatorët e tjerë dominantë.

Pra, niveli i kërkuar i asimetrisë së Albtelecom me Vodafone dhe Telekom Albania është i domosdoshëm edhe në një orvajtje për të korrigjuar apo për të "shëruar" (remedy) pasojat e thella nga aplikimi i politikave të tilla me nivelin e MTR-ve të operatorëve, të cilat jo vetëm nuk kanë mundur të adresojnë problemet e konkurrencës të evidentuara në Analizat e mëparshme por përkundrazi kanë kontribuar që operatori dominant të forcojë pozitën e tij në tregun e komunikimeve elektronike. Këta operatorë, veç e veç apo të dy së bashku, duke shfytëzuar këtë pozitë janë përfshirë edhe në praktika antikonkurrese duke bërë të vështirë mbijetesën e operatorëve të vegjël, duke detyruar deri në daljen e tyre nga tregu (rasti PLUS) dhe me krijimin e premisave për rikthimin e situatës monopolistike apo duopolistike. Në mungesë të marrjes së masave të duhura proporcionalisht me problematikat e ndeshura, për të parandaluar përkeqësimin

e pozitës në treg të operatorit Albtelecom nga manifestimi i dukshëm i pozitës dominuese veçanërisht nga operatori Vodafone, do t'i lihej rrugë e hapur operimit duopolistik në tregun e komunikimeve elektronike.

Në përfundim, Albtelecom beson se me kushtet dhe ndryshimet e reja të ndodhura në tregun e telefonisë celulare ekzistojnë rrethana të mjaftueshme për përcaktimin në dokumentin final të rregullimit të tarifave të terminimit për:

- Aplikimin e MTR-ve asimetrike duke përdorur qasjen lineare, sipas dhe propozimit të Albtelecom. Bazuar në pjesët e tregut të operatorëve, MTR-të e arsyeshme duhet të jenë, Albtelecom 5.82, Telekom Albania 3.82 dhe Vodafone 1.48.

- Në mënyrë të përmbledhur propozimi i Albtelecom jepet në tabelën e mëposhtme:

<b>01.04.2018 -</b>		
<b>Glide-path</b>	<b>Tarifat aktuale</b>	<b>(deri në një vendim tjetër të AKEP)</b>
<b>Albtelecom</b>	<b>1.48</b>	<b>5.82/5.62 (*)</b>
<b>Telekom Albania</b>	<b>1.48</b>	<b>3.82 / 3.28/1.22 (*)</b>
<b>Vodafone</b>	<b>1.48</b>	<b>1.48/ 1.22/1.11 (*)</b>

*(\*)AKEP mund të kryej vlerësimin konkret sipas pjesëve të tregut nga të dhënat me të fundit zyrtare*

Megjithëse vlerësojmë AKEP për vlerat e MTR-ve të propozuara në dokumentin e tij, asimetria e tarifave të terminimit e pashoqëruar nga vlerat dhe afati kohor të kërkuara nga Albtelecom, nuk do mund të rikuperonte pasojat e krijuara në tregun e komunikimeve elektronike për një konkurrencë efektive dhe as nuk do i jepte mundësinë operatorit Albtelecom për investimet e nevojshme në përgjigje qoftë të kërkesave të qeverisë shqiptare për rritjen e penetrimit në shërbimet broadband dhe po ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve inovatore ndaj përdoruesit fundorë.

Lidhur me periudhën afatshkurtër të aplikimit të nivelit të asimetrisë prej 118% të propozuar nga AKEP, krahasimisht me shtrirjen kohore relativisht të gjatë të masave rregullatore të aplikuara deri tani ndaj operatorëve celularë, Albtelecom gjykon se nuk mund të mendohet se masat e propozuara rishtazi do mund të lehtësojnë pasojat e parikuperueshme të konkurrencës në treg, propozuar për tu aplikuar në një periudhë kaq të shkurtër kohore (vetëm 1 vit), të nivelit të asimetrisë që është menduar nga AKEP si kohë/masë e arsyeshme.

Prandaj ne gjykojmë se, aplikimi i asimetrisë së tarifave të terminimit në masën e kërkuar nga Albtelecom, dhe në çdo rast jo më pak se niveli i propozuar nga AKEP, duhet të jetë i shtrirë në kohë të paktën deri në Analizën e radhës, ku pasi të analizohen të dhënat e tregut nga efektet dhe impakti që mendohet të japin masat e reja rregullatore, do mund të gjykohet më tej për masa të tjera apo kalimin drejt masave rregulluese që aplikohen në kushtet e përmirësimit apo arritjes së konkurrencës efektive.

Kjo periudhë me tarifa asimetrike të terminimit sipas propozimit të Albtelecom, deri në Analizën tjetër të radhës së tregut celular, është kohë e mjaftueshme për të gjykuar mbi zhvillimet, ecurinë dhe praktikën në vazhdimësi që do të ndiqen nga Vodafone dhe Telekom Albania, në vijim të përqëndrimit të tregut dhe të fuqizimit të mëtejshëm të tyre me asete e frekuenca, duke mos përkeqësuar kështu paraprakisht situatën financiare të rënduar tashmë të Albtelecom.

Ne insistojmë për implementimin e tarifave të terminimit asimetrike (sipas propozimit tonë), të cilat në mënyrë të njëkohshme me detyrime të tjera që duhet t'iu vendosen operatorëve dominantë Vodafone Albania dhe Telekom Albania, në tregun me pakicë të telefonisë celulare apo në tregun me shumicë të akses origjinitiv të thirrjeve, në kuadër të Analizave përkatëse të tregut të publikuara për konsultim, do të ndikojnë për ribalancimin e pjesëve të tregut të operatorëve si dhe do të sigurojnë konkurrencën e drejtë dhe të ndershme në treg.

#### Telekom Albania

Propozimi i AKEP për rifutjen e asimetrisë së MTR të Albtelecom në raport me dy operatorët Vodafone Albania dhe Telekom Albania me vlerat e publikuara në dokumentin e analizës së tregut jo vetëm që nuk krijon impakt pozitiv apo neutral për shoqërinë Telekom Albania, por krijon efekte negative. Asimetria e propozuar midis TA dhe VAL dhe TA dhe Albtelecom krijon një situatë negative financiare për shoqërinë TA si në 2018 ashtu edhe për 2019 duke renduar më tej TA me kosto interkoneksioni shtesë, respektivisht me 300 K Euro inkrementale dhe 400 K Euro inkrementale për 2017 dhe 2018.

Me këtë asimetri të propozuar dhe me kombinimin e nxjerrjes nga rregullimi në tregun me pakicë i Albtelecom (i propozuar në dokumentin e analizës së tregut celular miratuar me Vendimin nr.16, datë 22.02.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP), krijohet mundësia që

Albtelecom të konkurrojë në treg me një vlerë të lartë të MTR si dhe mundësinë për të ofruar tarifa/volume të ndryshme on-net/off-net. Në këtë mënyrë Albtelecom e ka shume të lehtë të rrisi pjesën e tij të tregut. Duke u rritur pjesa e tregut e Albtelecom do të rritet trafiku dalës drejt Albtelecom duke pasur një lëvizje të tij nga Vodafone tek Albtelecom, ndërsa trafiku hyrës nga ana e Albtelecom do të zvogëlohet sepse ai do ta mbledhë në rrjetin e tij (efekti club), ndërsa trafiku hyrës i Vodafone Albania do të zhvendoset drejt Albtelecom.

Në këto rrethana kjo do të sjellë rritjen e mëtejshme të kostos së interkoneksionit për TA dhe duke rritur më tej efektin negativ të asimetrisë siç është propozuar me kombinim të përjashtimit të Albtelecom nga rregullimi i tregut retail për mosdiskriminim on-net/off-net për tarifatat dhe volumet. Ky propozim për asimetrinë i kombinuar me përjashtimin e Albtelecom nga rregullimi i tregut retail sjell një risk mjaft të lartë për humbje të pjesës së tregut të TA duke pasur një impakt negativ në të ardhurat nga ana e tregut retail e cila në vlerësimin e TA është rreth 600 mijë Euro për 2018, duke çuar në një impakt negativ në total prej 1 milion Euro për TA për 2018 inkrementale. E gjithë kjo vlerë i transferohet Albtecom si e ardhur shtesë me këto masa rregulluese, çka në raport me shoqërinë tonë është tërësisht e pajustificuar nga pikëpamja rregullatore.

Analiza e tregut të terminimit të trafikut kombëtar në rrjetet celulare për rregullimin e MTR-ve nuk duhet të konsiderohet e veçantë, sidomos kur për tregun e shitjes me pakicë AKEP ka parashikuar sanksione/obligime të tjera. Është e evidente se kjo analizë e tregut për MTR duhet të ishte e përfshirë në analizën e tregut celular të miratuar me Vendimin nr.16, datë 22.02.2018, në mënyrë që të analizohet së bashku me analizën për tregun me pakicë, sepse kombinimi i tyre siç u tregua me analizën e mësipërme favorizon Albtelecom në të dy këto tregje.

Më tej Albtecom është një kompani e cila operon në tregun fiks dhe celular. AKEP nuk ka bërë asnjë analizë për avantazhet që Albtelecom ka në treg për shkak se operon si në tregun e telefonisë fikse ashtu dhe në tregjet e broadband nga vendndodhje fikse. Albtelecom përveç se ka një pozitë të konsoliduar në tregun e telefonisë celulare ai dhe është operatori më i madh në tregun e telefonisë fikse, avantazhet e të cilit mund t'i shfrytëzojë dhe në tregun celular (siç është ai nëpërmjet ofrimit të paketëve të konverguara fiks dhe mobile), duke i dhënë kështu përparësi dhe një avantazh të ndjeshëm në raport me TA që operon vetëm në tregun celular.

Rritja e tarifës së Albtelecom gjatë fazës nga 1,48 lekë në 2,66 lekë/min dhe efektet e evidentuara nga AKEP të këtij ndryshimi në lidhje me ndikimin në kostot e Telekom Albania sipas formulës së propozuar me anë të raportit të trafikut on-net/off-net nëse i marrim në raport me avantazhet që ka Albtelecom për shkak të pozitës dominante në telefoninë fikse dhe transferimit të saj në telefoninë celulare nëpërmjet diversifikimit të shërbimeve (fiks me ato mobile në një paketë bundle si psh fix/celular/IPTV) dhe me anë të teknikës së bundling, dy elementë këto të parashikuara dhe në Udhëzimin e Komisionit Europian 2002/C 165/03 për analizën e tregut dhe vlerësimin të FNT, janë tërësisht të papërfillshme.

Rritja e tarifës së terminimit për Albtelecom duhet konsideruar dhe në raport me pjesën e tregut që ka ky operator në tregun e telefonisë fikse si operatori inkumbent dhe për rrjedhojë dhe avantazhet që ai gëzon në këtë treg, ekonomitë e shkallës, diversifikimi i produkteve nëpërmjet teknikave të bundling midis shërbimeve të telefonisë fikse dhe asaj celulare apo dhe të internetit të integruara në një paketë të vetme (ofertat mobile+fiks siç është grupi Superfamilja që përfshin IPTV, telefoni fikse, internet dhe paketë mobile), integrimi horizontal në të dyja tregjet e telefonisë fikse dhe asaj celulare (duke vepruar si një operator i integruar fiks+mobile). Nëpërmjet këtyre faktorëve, Albtelecom ka avantazhe të dukshme në raport me TA, që operon vetëm në tregun e telefonisë celulare, pasi zgjerimi i ndikimit të pozitës dominante nga telefonua fikse shtrihet për rrjedhojë dhe në telefoninë celulare, dhe në këtë mënyrë, këto avantazhe përforcohen akoma më tepër me rritjen e tarifës së terminimit celular për Albtelecom në 2,66 lekë/min. Pra, është evidente një trajtim favorizues për operatorin Albtelecom dhe haptazi diskriminues ndaj Telekom Albania, duke cënuar rëndë pozitën e ekonomiko-financiare në treg, pasi nuk ka asnjë arsye apo rrethanë të një kthimi prapa në kohë të asimetrisë në tarifën e terminimit midis operatorëve kështu siç propozohet.

Ky propozim është në shkelje të hapur të të gjithë parimeve të kuadrit rregullator si të BE-së dhe të legjislacionit shqiptar, “parimi i mos-diskriminimit, parashikuar në nenin 8, parag.3/c, Direktiva Kuadër 2002/21, e ndryshuar”.

Ky qëndrim i AKEP do të sjellë dëme të konsiderueshme të financave për TA që do të rrjedhin nga aplikimi i këtij propozimi. Ky propozim shkakton jo vetëm dëmtim dhe cënim të pozitës financiare të Telekom Albania në treg, por dhe një pasiguri në zhvillimin e planeve të biznesit në të ardhmen, pasi në një hark kohor brenda një viti AKEP ndryshon disa herë qëndrimin në propozimin e tij për nivelin e tarifave të terminimit duke treguar në këtë mënyrë një mungesë koherence në propozimet dhe masat rregulatore të ndërmarra, një sjellje favorizuese për Albtelecom dhe diskriminuese kundrejt TA.

Gjithashtu AKEP nuk mund të justifikohet me faktin se pozitën e Albtelecom janë rënduar pasi Albtelecom në periudhën 2014-2016 ka pasur një pozitë tregu të pandryshuar të pjesëve përkatëse të tregut në terma të të ardhurave totale, të numrit të kartave SIM për akses në broadband apo të numrit të përdoruesve aktivë, gjë e cila pra i referohet një situatë të qëndrueshme që në asnjë mënyrë nuk mund të justifikojë futjen e asimetrisë së MTR-ve duke aplikuar një tarifë më të lartë drejt rrjetit të Albtelecom, pasi një veprim i tillë është një ndërhyrje plotësisht absurde dhe në këtë mënyrë subvencionohet indirekt ky operator me anë të një propozimi të tillë, duke goditur rëndë konkurrencën dhe në këtë mënyrë, me rritjen e tarifës së terminimit të Albtelecom, kjo do të reflektohet dhe në ofertat retail me çmime më të larta për abonentët për thirrjet që ata do të kryejnë drejt rrjetit Albtelecom, pasi rritja e tarifës së terminimit përbën një rritje të kostove përkatëse për dy operatorët e tjerë.

Kalimi nga simetria e plotë në nivelet e propozuara të asimetrisë gjatë periudhës 1.05.2018-1.11.2020, midis tarifave përkatëse të terminimit gjatë fazës së parë për Telekom Albania dhe Albtelecom, është krejtësisht favorizues për Albtelecom

Në veçanti niveli mjaft i lartë prej 80% gjatë fazës së parë për TA dhe Albtelecom, kur aktualisht jemi në një situatë të plotë simetrie dhe kalimi i menjehershëm nga 0 në 80% të asimetrise me Albtelecom është totalisht absurd dhe i pabazuar në asnjë praktikë rregullatore, dhe gjithashtu kjo asimetri është dhe shume herë më e lartë se mesatarja prej rreth 35% midis tarifës së terminimit të operatorit që ka hyrë në treg 6-11 vjet më vonë dhe tarifës së terminimit më të ulët të operatorëve më të hershëm në treg, siç citohet dhe në faqen 86 të dokumentit “ERG (07) 83 final 080312 ERG's Common position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates”.

Në përfundim, Telekom Albania gjykon se niveli i asimetrisë së tarifave të terminimit të propozuar me operatorin Albtelecom i kombinuar me heqjen e detyrimit të mosdiskriminimit të tarifave on-net/off-net për Albtelecom, dëmton pozitat financiare të TA, me implikimet e konsiderueshme ekonomiko financiare, si dhe në dëm edhe të interesave të përdoruesve fundorë, pasi kjo do të reflektohet në çmime më të larta për ta. Gjithashtu ky propozim është i pajustificuar në formën e paraqitur nga pikëpamja rregullatore.

#### Vodafone Albania

Jo. Vodafone kundërshton fuqimisht propozimin e AKEP-it dhe mendon se është totalisht i pabazuar dhe në kundërshtim me të gjithë praktikën e mira apo kuadrin rregullator që vetë AKEP-i ka përdorur në arsyetimin e analizës. Komisioni Evropian ka kërkuar që të gjithë anëtarët e Autoriteteve Rregullatore nga 2009 të zbatojnë një lloj të caktuar metodologjie kostoje (BU-LRIC) për të vendosur tarifën e terminimit<sup>14</sup>. Vodafone ka kërkuar gjithmonë nga AKEP-i që të zbatojë këtë kërkesë sipas parashikimit të Komisionit Evropian, por AKEP-i nuk është përgjigjur asnjëherë pozitivisht dhe ka vazhduar të zbatojë metodën benchmark, gjë që është në kundërshtim me kuadrin rregullator të brendshëm dhe atë evropian duke qenë se mund të lerë vend për masa të papërshtatshme dhe joproportionale rregullatore për tarifën dhe, si në këtë rast duke propozuar tarifa asimetrike. Normalisht tarifën e terminimit duhet të jenë simetrike dhe asimetria duhet të jetë e justifikuar si duhet në bazë të diferencave objektive të kostos jashtë kontrollit të operatorëve në fjalë<sup>15</sup>, përndryshe tarifën asimetrike mund të jenë të rrezikshme dhe mund të pengojnë konkurrencën dhe inovacionin. Justifikimet e mundshme mund të jenë afatgjata në konkurrencë. Megjithatë, përgjithësisht pranohet që kjo politikë mund të tërheqë diferencat objektive të kostos së rrjetit për shembull për shkak të diferencave të kostove midis operimit të një rrjeti GSM 900 dhe një rrjeti DCS1800, ose diferencat e konsiderueshme në datën e hyrjes në treg. Një argument kyç që përdoret për të mbështetur autorizimin e tarifave të përkohshme asimetrike në favor të një operatori, është kur ky i fundit është një hyrje e re në treg.

<sup>14</sup> "Rekomandimi i Komisionit Evropian 2(X)9/396/KE date 7maj 2009 "Për rregullimin e tarifave të terminimit fikse dhe celulare në BE

<sup>15</sup> Injejt i arsyetimit është paraqitur në dokumentin eERG për qëndrimin e përbashkët mbi simetrinë e tarifave të terminimit të thirrjeve fikse dhe celulare



Kjo njihet si politika e ndihmës në hyrje, e cila synon promovimin e hyrjeve të reja me efekte hyrje jo eficiente. Komisioni Evropian ka theksuar se fakti që një operator që ka hyrë në treg më vonë dhe që si pasojë ka një pjesë më të vogël të tregut mund të justifikojë tarifa më të larta terminimi për një periudhë të kufizuar kalimtare, e cila nuk duhet të tejkalojë katër vjetë pas hyrjes në treg. Vazhdimi i aplikimit të një tarife më të lartë të terminimit nuk do të justifikohet pas një periudhe mjaftueshëm të gjatë për operatorin që ai t'u përshtatej kushteve të tregut dhe të bëhet me eficient dhe mund të dekurajonte edhe operatorët më të vegjël nga përpjekja për të zgjeruar pjesën e tyre të tregut.

Përveç kësaj, ERG-ja në dokumentin mbi qëndrimin e përbashkët për simetrinë e tarifave të terminimit të thirrjeve fikse dhe celulare, të cilin AKEP-i e përdor si reference kryesore për të mbështetur arsyetimin e tij në dokumentin për këshillim publik, parashikon në mënyrë specifike përjashtimet nga simetria dhe justifikimin e tyre si më poshtë vijon:

*1. Përjashtimi nga simetria i justifikuar nga diferenca objektive e kostove të jashtme<sup>16</sup>.*

Kur ka diferenca në kosto që vijnë për shkak të faktorëve të jashtëm jashtë kontrollit të operatorëve, tarifatat asimetrike që pasqyrojnë diferencat e kostove mund të jenë të justifikuar. Për shembull, kur procesi i liçencimit të spektrit nuk është kryer në atë mënyrë që të gjithë lojtarët aktiv në treg të kenë blerë liçencat e tyre me çmimet e tregut zakonisht përmes një ankandi, operatorët mund të përballen me diferenca kostosh që janë jashtë kontrollit të tyre. Duke supozuar që këto diferenca kostosh janë vlerësuar si duhet ato mund të justifikojnë një asimetri (kushtet e tregut të brendshëm mund të justifikojnë promovimin e simetrisë, edhe pse diferencat objektive të kostos ekzistojnë ende, ose diferencat e kostos mund të konsiderohen si shumë të pasigurta ose të kufizuara për t'u marrë parasysh). Megjithatë, organet rregullatore duhet të mendojnë sa më shpejt të jetë e mundur, nëse është e përshtatshme të eliminojnë diferencat e kostove si pasojë e shpërndarjes së frekuencave qoftë duke bashkërenduar dhënien e spektrit operatorëve, ose duke siguruar që liçencat të merren me çmimin e tregut, në mënyrë që të eliminohet asimetria.

Vodafone pranon që MTR-të e rregulluara duhet të pasqyrojnë rrjetet me diferenca të pashmangshme kostosh. Shpesh diskutohet që kjo duhet të përfshijë pasojat e caktimit të spektrit të radiofrekuencave të ndryshme (p.sh. 900MHz vs. 1800MHz). Me rritjen e trafikut në rrjet diferencat e kostos për shkak të caktimit të spektrit ulen me shpejtësi. Rritja e ndarjes së qelizave për shkak të vëllimeve në rritje të trafikut të rrjeteve celulare do të thotë që një proporcion më i lartë pikash kanë kapacitet të kufizuar (me më pak pika mbulimi respektivisht) dhe ka një diferencë më pak efektive të kostos midis rrjeteve 90MHz dhe 1800MHz.

---

<sup>16</sup> Komisioni pranon se, në rastet e caktuara të jashtëzakonshme, një asimetri mund të justifikohet nga diferencat objektive të kostove të cilat janë jashtë kontrollit të operatorëve në fjalë, si topologjite e ndryshme të rrjetit për shkak të përdorimit të brezave specifike të frekuencave (Case IT/2007/06S9)

## 2. Përjashtimi nga simetria për një periudhë kalimtare për hyrës shumë të vonë në treg<sup>17</sup>.

Fakti që një operator ka hyrë më vonë në treg mund të justifikojë një asimetri për një periudhë kalimtare. Duhet pasur parasysh avantazhet që ka lejimi i një hyrësi të ri që të rikuperojë kosto të tij eficientë, si dhe efektet e mundshme negative të një asimetrie të "paarsyeshme".

Vodafone është në dijeni të faktit se shpesh diskutohet që operatorët që hyjnë vonë në treg nuk arrijnë kurrë të fitojnë mjaftueshëm pjesë të tregut pa ndihmën e një MTR-je më të lartë. Kjo për shkak të një sërë arsyesh të palidhura me ekonominë e shkallës, të tilla si mungesa e një brandi ekzistues, mungesa e aksesit në pikat "më të mira" të transmetimit ose kostot e ndërrimit të pajtimtarëve. Shumica e këtyre pretendimeve janë subjektive, të pabazuara në prova reale; përkundrazi, ato shkurajojnë rritjen e hyrjeve të vona. Ne kemi një precedent të freskët me Plus Communications që nuk arriti kurrë të bëhet një operator eficient.

Në fakt, pranohet që MTR-të asimetrike shtrembërojnë konkurrencën - sigurisht ato duhet ta bëjnë këtë në mënyrë që të "kompensojnë" për disavantazhet konkurruese me të cilat pretendohet se përballen hyrësit e vonë. Nëse MTR-të asimetrike nuk kanë pasur asnjë ndikim mbi konkurrencën, atëherë është e vështirë të kuptohet se pse duhet t'i përdorin organet rregullatore. Megjithatë, pretendohet gjithashtu që përfitimet që vijnë nga këto asimetri - në formën e rritjes së konkurrencës që vjen nga hyrësit e rinj që mund të dalin nga tregu - e justifikojnë ndërhyrjen<sup>188</sup>.

Profesor Valletti shpjegon pasojat e një ndërhyrjeje të tillë:

*Jo vetëm që këto kosto të larta do t'u mbulojnë operatorëve më pak eficientë, por do t'ua kalojnë ato operatorëve të tjerë celularë të cilëve u është dashur të terminojnë thirrjet me pajtimtarët e tyre. Si rrjedhim, kostot e operatorëve më eficientë do të rriteshin në mënyrë të papërshtatshme. Paralelisht kostot e operatorëve më pak eficientë do të reduktoheshin nga tarifrat më të ulëta të terminimit të operatorëve më eficientë. Këto diferenca në kosto do të ndikonin në çmimet e pajtimtarëve. Kjo do të shtrembëronte më tej modelin e konkurrencës midis operatorëve celularë duke krijuar një rreth vicioz. Jo vetëm që operatorët më pak eficientë do të mbroheshin ndaj eficientësisë së tyre më të ulët por do të fitonin relativisht ndaj operatorëve më eficientë.*

*Kështu, rregullorja asimetrike e rrjeteve më të mëdha, që u kërkon vetëm atyre të reduktojnë tarifrat e terminimit duke i nxitur rrjetet më të vogla që të vendosin tarifa më të larta terminimi,*

<sup>17</sup> Komisioni shpjegon që "fakti që një MNO ka hyrë me vonë në treg dhe ka si rrjedhim një pjesë me te vogël të tregut mund të justifikojë tarifa të larta terminimi për një periudhë të kufizuar kalimtare. Vazhdimi i përdorimit të një tarife me të lartë të terminimit nuk do të justifikojë pas një periudhe mjaftueshëm të gjatë për operatorin që të përshtatet kushteve të tregut dhe të bëjë eficient dhe madje mund të dekurajonte operatorët me të vegjël nga zgjerimi i pjesës së tyre të tregut" (Rasti BE/2006/0433, Rasti FR/2006/0461)

<sup>188</sup> Kjomerrët parasysh në modelimin e detajuar të autoreve si Peitz (2005), icili thekson faktin se pavarësisht se tarifrat asimetrike të terminimit mund të nxisin hyrjen në treg, ato rezultojnë në një humbje neto të mireqenies ekonomike dhe reduktojnë incentivat e investimit për firmën e stabilizuar. Shihni Peitz, M. "Rregullimi asimetrik i aksesit dhe diskriminimi i çmimit në telekomunikacion", Universiteti Nderkombëtar i Gjermanisë, Shkolla e Administrimit të Biznesit, Dokument Pune 28/2005, janar 2005

*ka tendencën të shtrembërojë procesin e konkurrencës. Asnjë operator, ceteris paribus, nuk do të donte të bëhej më i madh se rivalët e tij: nëse kjo do të thoshte se ai do të penalizohej në fund në krahasim me rivalët e tij. Në një kontekst të ngjashëm, konkurrenca për tregun do të ndalej dhe çmimet ndaj përdoruesve fundorë do të ishin më të larta<sup>19</sup>.*

Si më lart duhet të theksohet një pikë e rëndësishme, nga e cila tregu shqiptar ka vuajtur për më shumë se 8 vjetë, ku MTR-të asimetrike nuk inkurajojnë operatorët që të konkurrojnë për pjesë tregu. Operatorët më të vegjël rrezikojnë të humbasin subvencionin e tyre nëse rriten, ndërkohë që operatorët më të mëdhenj penalizohen nga organi rregullator për madhësinë e tyre. Kjo duhet të mjaftojë që AKEP-i të bëhet shumë skeptik ndaj MTR-ve asimetrike si zgjidhje; pasi sapo ato fillojnë aplikohen, kanë shumë pak mundësi të ndryshojnë kushtet e konkurrencës në mënyrë të tillë që të lehtësojnë heqjen e tyre. Kjo është arsyeja pse Qëndrimi i Përbashkët i ERG-së është përdorur si udhëzues në këtë drejtim.

Shkalla dhe natyra e shtrembërimeve të krijuara nga MTR-të asimetrike bëjnë që avokatët e aplikimit të tyre të kuptojnë që duhet të ngrihet një lloj justifikimi "objektiv" për t'i mbështetur. Dokumenti i ERG-së merr parasysh faktorët që përdoren zakonisht për të justifikuar asimetritë. Disa nga këto, si "hyrja e vonë në treg" e firmave janë pa asnjë bazë në kohët e sotme.

Megjithatë, AKEP-i ka arritur në një zgjidhje që nuk është as e arsyeshme, pasi nuk mbështetet nga asnjë doktrinë apo praktikë në sektor (siç u përmend më lart) dhe as e ligjshme, pasi është në kundërshtim me ligjin dhe kuadrin rregullator. Duke përdorur këtë praktikë, AKEP-i po shkel thelbin e misionit të tij të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit: *AKEP-i nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera, ndër të tjera, për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.*

Tarifa të zbatueshme të Terminimit Celular (MTR-të) në Bashkimin Evropian përputhen plotësisht me rekomandimin në të gjithë tregjet evropiane ku shumica e Autoriteteve Rregullatore përdorin modele kostosh me qasjen LRIC "të pastër" nga poshtë-lart bazuar në kostot aktuale<sup>20</sup>.

---

19 Valletti, T. "Rregullimi asimetrik i tarifave të terminimit celular". Imperial College Londer dhe Universiteti i Romes, dhejtor, 2006

<sup>20</sup> 3 shtete kanë aktualisht MTR asimetrike;

- Qiproja është i vetmi vend anetar i BE-se me MTR asimetrike por kjo e fundit është e justifikuar pasi i është dhënë hyresit të ri në tregun celular (Primetel në 2014) për një periudhë prej 4 vjetësh (deri në 2018).
- MTR-te asimetrike janë të parregulluara. Në fakt, në Zvicër MTR-te nuk janë rregulluar kurrë sepse vlen parimi i rregullimit ex-post. Keshtu Autoriteti Rregullues mund të rregullojë vetëm MTR-te sipas ankesave nga një operator për shkelje të ligjit të konkurrencës.
- Turqia është i vetmi shtet që nuk ka konsideruar kurrë futjen e tarifave simetrike pa një arsye të qarte. Duket se draft masat e propozuara të AKEP-it i afrohen praktikës së Rregullatorit Turk në vend të atij të shteteve të BE-se.

## Oëndrimi i AKEP

Në lidhje me komentet për këtë pyetje, AKEP ka dhënë argumenta shtesë në këtë dokument final për rregullimin e MTR si dhe në qëndrimet për komentet e tjera më sipër.

Propozimi për asimetri ishte një nga alternativat e propozuara në konsultimin publik dhe u bazua në disa argumenta, përfshirë trafikun jo-të balancuar midis tre operatorëve dhe pagesat neto midis tyre sa i përket termnimit të thirrjeve midis operatorëve.

Megjithatë bazuar në:

5. Dokumentin e ERG (ERG 07 83 final 080312) i cili rekomandon se asimetria nuk është më e justifikuar kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
  - c) nuk ka më disbalanca të trafikut ose ato nuk vijnë për shkak të strategjive të operatoreve;
  - d) MTR-të e operatorëve të medhenj nuk janë shumë më të larta se kosto.
6. Rekomandimin e KE për aplikim të modelit Pure LRIC dhe MTR simetrike.

*AKEP në këtë dokument final pas këshillimit publik ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë, si dhe uljen e mwtejsheem tw tyre pwr ti barazuar me benchmarkun me te fundit te MTR te vendeve te BEREC qe kane aplikuar model kostoje LRIC i paster. Kjo eshte ne perputhje dhe me objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit "Për komunikimet elektronike në RSH" si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC.*

Në lidhje me komentet e Telekom Albania që bëjnë lidhje midis MTR dhe detyrimit për mos-diskrimin në tarifatat me pakicë të thirrjeve on-net/off-net, AKEP sqaron se diskutimi për këtë detyrim (mos-diskrimin në tarifatat me pakicë të thirrjeve on-net/off-net) është pjesë e dokumentit të analizës së tregut "Tregjet me shumice të akses-origjinimit, termnimit të thirrjeve nderkombetare dhe tregjet e pakices" dhe vendimet finale të AKEP janë marre në përfundim të procedurës përkatëse të këshillimit publik.

## **6. A jeni dakort me propozimin e AKEP për aplikim asimetrie edhe për Telekom Albania në raport me Vodafone Albania për një periudhë një vjecare?**

Telekom Albania

Bazuar në të dhënat e tregut të referuara nga AKEP në faqet 28-33, të Seksionit V.3, "Fuqia e ndjeshme në treg", në dokumentin e analizës së tregut miratuar me anë të Vendimit të KD Nr. 16, datë 22.02.2018, lidhur me disa tregues si, të ardhurat e operatorëve, numrit të përdoruesve, trafikut të thirrjeve, etj, shihet qartë se Vodafone Albania ka pjesë mjaft të larta të pjesëve të

tregut mbi 50% në të gjithë këto parametra. Në disa prej këtyre treguesve si, të ardhurat retail, numri i përdoruesve aktivë broadband, SMS dalëse apo trafiku i të dhënave, pjesët përkatëse të tregut që zotëron Vodafone Albania e kalon nivelin 50%.

AKEP ka analizuar tregun me pakicë dhe të ardhurat që gjenerojnë operatorët në këtë treg. Bazuar në këtë analizë, operatori me pjesën më të madhe në treg është Vodafone Albania. Siç është evidentuar nga AKEP, pjesët e tregut të Vodafone në terma të të ardhurave me pakicë janë rritur gjatë periudhës 2011-2016, duke arritur nivelin më të lartë të pjesës së tregut me pakicë në afërsisht 56% në vitin 2016 (faqja 29 e dokumentit). Ndërsa në të njëjtën kohë, Telekom Albania ka shënuar një trend në rënie në këtë tregues nga 36% në vitin 2011 në afërsisht 28% në vitin 2016.

Pjesa e tregut e një operatori është një nga kriteret bazë për të përcaktuar nëse ai operator është dominant në një treg të caktuar. Sa më i qëndrueshëm në kohë të jetë ky tregues aq më i rëndësishëm është ky element për të evidentuar nëse ky operator ka FNT në tregun nën shqyrtim siç është dhe rasti i analizuar i pjesëve të tregut të Vodafone Albania, i cili karakterizohet nga pjesë të larta mbi 50% të tregut për një periudhë të gjatë kohore nga viti 2011 e në vazhdim.

Bazuar në legjislacionin e BE-së, më specifikisht në Udhëzimin e Komisionit Europian 2002/C 165/03 si dhe praktikën rregullatore, kemi problem të dominancës në treg kur një operator zotëron i vetëm mbi 40% të tregut. Në këtë rast inicohet nga autoriteti përgjegjës rregullator përcaktimi i këtij operatori me FNT në treg, dhe veçanërisht kur tejkalohet 50% i pjesës së tregut, kjo është mëse e mjaftueshme për të prezumuar pozitën e tij dominante në treg (si në rastin e nivelit të të ardhurave në tregun retail apo të numrit të SMS dalëse në mbi 60%).

Gjithashtu, edhe në fushatën e saj publicitare Vodafone pretendon që ka 60% të pjesëve të tregut duke thënë, "6 nga 10 kanë Vodafone".

Për shkak të pozitës dominante si rrjedhojë e pjesëve mjaft të larta të tregut të zotëruara nga Vodafone Albania në tregun e komunikimeve elektronike, shoqëria Telekom Albania vlerëson se operatori Vodafone Albania i plotëson të gjitha kushtet për të pasur statusin me FNT në treg.

Për më tepër, bazuar në të dhënat e referuara nga AKEP në analizën e tregut celular, Telekom Albania gjatë viteve të fundit ka pësuar rënie të pjesëve të tregut në disa tregues si, niveli i të ardhurave, numri i përdoruesve të shërbimeve celulare apo atyre broadband, etj *dhe për rrjedhojë nuk i plotëson kushtet për FNT në këtë treg, prandaj dhe propozimi për asimetrit e MTR-ve është dhe proporcional në raport me pozitat relative në treg midis TA dhe VDFAL.*

Referuar të dhënave të publikuara nga AKEP në këtë dokument shihet qartë që Vodafone Albania është *net receiver* në trafikun hyrës-dalës të interkoneksionit me të dy operatorët e tjerë.

Në këto kushte kur Vodafone Albania zotëron mbi 50% të tregut, trafiku hyrës i interkoneksionit është më i lartë se trafiku dalës i tij (net receiver) dhe propozimi i AKEP që mosdiskriminimi on-net/off-net të vazhdojë dhe për TA e cila ka vetëm 28% të tregut, asimetria e propozuar nga ana e AKEP është e pamjaftueshme për të dhënë efekte pozitive në treg.

Vodafone Albania

Si u përmend më lart, qasja e AKEP-it ndaj aplikimit të çdo mase rregullatore pa analizat e duhura, udhëzimet përkatëse, studime gjithë përfshirëse të tregut, le hapësira për çdo masë abuzive dhe çon në një situatë absurde dhe të rrezikshme për sektorin dhe ekonominë shqiptare në përgjithësi. Nëse AKEP-i nuk ndjek udhëzimet dhe rekomandimet evropiane<sup>21</sup>, por e orienton tregun tonë drejt praktikave abuzive jashtë tregut evropian, atëhere ne jo vetëm jemi duke shkelur detyrimet tona ligjore dhe angazhimin si Vend Kandidat për Anëtarësim në Evropë, por po japim edhe mesazhe të forta dekurajuese për investitorët potencialë dhe i largojmë ata aktualë.

Rasti më i fundit i propozimit të zbatimit të tarifave asimetrike ka ndodhur në Sllovaki ku rregullatori sllovak, RU, propozoi në nëntor të 2017 reduktimin e MTR-së në 0.825 eurocent/min si rezultat i shqyrtimit të dytë të modelit të tij LRIC të pastër nga poshtë-lart.

RU propozon gjithashtu vendosjen e një MTR-je asimetrike prej 0.908 Eurocent/min 10% më e lartë për Sëan Mobile, një hyrës i ri me 3.23% të tregut. Sëan Mobile hyri në tregun sllovak në tetor 2015. Që atëhere, ka zbatuar në mënyrë vullnetare MTR-të simetrike me tre MNO (operatorë të rrjeteve celulare) të tjera.

Asimetria në MTR nuk është më e zakonshme në BE. Vetëm Zvicra, Qipro dhe Turqia kanë MTR asimetrike siç tregohet dhe nga harta dhe shpjegimi përkatës më lart. Rekomandimi i Komisionit Evropian në maj 2009 nuk i lejon autoritetet rregullatore të vendosin një MTR më të lartë për hyrësit e rinj. Në këtë rast Autoriteti Rregullator duhet të tregojë që hyrësi i ri po operon nën shkallën minimale të efikasitetit dhe përballet me kosto shtesë më të larta për njësi, krahasuar me operatorin model dhe që periudha e asimetrisë nuk duhet t'i tejkalojë katër vjetët.

Si BEREC<sup>22</sup> ashtu dhe komisioni, vunë re që RU nuk arriti të justifikojë si duhet dhe objektivisht arsyen pse Sëan Mobile kishte një kosto më të lartë për njësi krahasuar me operatorët e tjerë. Komisioni i rekomandon RU-së zbatimin e MTR-ve simetrike pa vonesë. Përveç kesaj, Komisioni arriti në përfundimin se tarifat e pajustificuara asimetrike në favor të Sëan Mobile do të shkelnin parimin e mosdiskriminimit<sup>23</sup>

I njëjti qëndrim u mbajt në rastin e Qipros ku, edhe pse lidhej me një hyrës të ri në treg, (Primetel, i cili hyri në treg në 2014) Komisioni theksoi se përpara se të lejoheshin MTR më të larta në krahasim me rivalët e stabilizuar- Autoriteti Rregullator do të duhej të provonte që një hyrës i ri ndeshet realisht me kosto inkrementale më të larta për njësi për shkak të shkallës së tij.

---

<sup>21</sup> Neni 7i ligjit nr.9918 date 19.05.2008 i ndryshuar, parashikon që AKEP merr parasysh rekomandimet përkatëse dhe vendimet e Komisionit Evropian dhe BEREC-it.

<sup>22</sup> Opinioni i BEREC-it për fazën II të hetimit BoR(17) 251. Rasti SK/2017/2010 Tregu i shumicës për terminimin e thirrjeve zanore rrjetet individuale celulare (tregu 2) në Sllovaki (masat)

<sup>23</sup> Me datë 24 tetor 2017, Komisioni Evropian dergoi një leter me dyshime serioze duke hapur një fazë II të hetimit sipas Nenit 7a të Direktives 2002/21/KE të ndryshuar sipas Direktives 2009/140/EC

Nga ana tjetër, AKEP-i, pa asnjë lloj analize dhe si rrjedhim pa një justifikim "objektiv", po propozon zbatimin e asimetrisë (në nivelin 118% krahasuar me 10% e RU) për operatorët e tjerë, kur asnjë nuk është hyrës i ri (Telekom ka qënë në treg për më shumë kohë se Vodafone) dhe pa diferenca objektive kostosh. Edhe nëse në mënyrë absurde do të merrnim parasysh si justifikim pjesën e tregut ndarja aktuale e tregut është përkatësisht Vodafone 48%, Telekom 33% dhe Albtelecom 14% (tepër e lartë në krahasim me rastin Sllovak). Këto masa janë propozuar pa analizuar zhvillimet e reja në treg pas daljes së Plus Communications dhe shpërndarjen përkatëse të klientëve të tij. Përkundrazi, AKEP-i, në konfuzion të plotë, fut këto masa pa baza konkrete dhe vetëm me justifikimin e pjesëve në treg. Ndërkohë që Komisioni Evropian sapo ka refuzuar futjen e masave të tilla nga RU në favor të Sëan Mobile, i cili është një hyrës i ri dhe me 3% të aksioneve në treg, pasi nuk ka një justifikim të përshtatshëm që e mbështet këtë ndërhyrje ekstreme.

Në shumicën e rasteve, Autoritetet Rregullatore mund të zbatojnë justifikimin objektiv për hyrësit tepër të vonë në vend të pjesëve të tregut pasi pasojat e diferencave në datat e hyrjes, të cilat janë në shumicën e rasteve jashtë kontrollit të operatorëve, janë më objektive se pjesa në treg dhe në rrethana të caktuara, mund të justifikojnë asimetritë kalimtare. Në fakt mund të vëzhgohen diferenca në pjesët e tregut midis dy operatorëve edhe nëse nuk ka diferenca në hyrjet në treg (në rastin tonë Vodafone ka hyrë edhe më vonë se Telekom). Në këto raste, faktorë të tjerë të brendshëm (pra nën kontrollin e operatorëve) mund të shpjegojnë këto diferenca në pjesët e tregut për shembull për shkak të diferencave të efikasitetit të tyre në drejtimin e rrjetit dhe biznesit në përgjithësi.

## Qëndrimi i AKEP

AKEP në këtë dokument final pas këshillimit publik ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë bazuar në objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit "Për komunikimet elektronike në RSH" si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-it. AKEP në këtë dokument final ka bërë argumentat përkatëse për vijim të simetrisë midis 3 MNO-ve dhe reduktim të mëtejshëm të MTR të tyre. Për më shumë mund ti referoheni qëndrimit të AKEP për pyetjen nr.5.

## 7. Cili është afati më i arsyeshëm për fillimin e aplikimit të Fazës I të MTR të rinj?

Albtelecom sh.a

Duke besuar në vullnetin e AKEP për të garantuar që ky përqëndrim i tregut nuk do të kufizojë nxitjen e konkurrencës, nuk do të shërbejë për forcimin e mëtejshëm të ushtrimit të fuqisë së ndjeshme vetëm për dy operatorët dominantë Vodafone dhe Telekom Albania, si dhe për të

evituar dobësimin e mëtejshëm të pozitive të Albtelecom në tregun e telefonisë së lëvizshme, i ndikuar ky i fundit gjithashtu edhe nga lufta e çmimeve e inicuar nga 2 operatorët kryesorë, Albtelecom i kërkon AKEP aplikimin sa më të shpejtë të tarifave të terminimit asimetrike (sipas propozimit të Albtelecom më sipër), konkretisht jo më vonë se nga 01.04.2018 deri në Analizën e radhës së tregut të terminimit për telefoninë e lëvizshme.

#### Telekom Albania

Duke qenë se për Telekom Albania tarifatat e terminimit celular midis operatorëve të propozuara nga AKEP kanë impakt negativ, TA gjykon që AKEP të fillojë në mënyrë sa më të shpejtë një studim për ndërtimin e një modeli për llogaritjen e kostove të terminimit. Në këtë mënyrë, ky model, i cili do të konsultohet me të gjitha palët e interesit, do të shërbejë si bazë për kalkulimin e niveleve të reja të tarifave të terminimit për të gjithë operatorët dhe në të cilin do të përcaktohen dhe afatet kohore përkatëse për fillimin e aplikimit të këtyre tarifave.

#### Vodafone Albania

Sic u tha më sipër, Vodafone është kundër reduktimit të MTR-ve në nivelin e 1.22 Lek/min brenda 2018. Vodafone kërkon që ky reduktim nga 1.48 në 1.22 Lek/min të nisë nga 1 janar 2019 në *nivel simetrik*. Reduktimi i MTR-ve duke nisur nga 1 janari do të ishte më i natyrshëm dhe në linjë me nivelin mesatar të tarifës së vendeve të BEREC-it të cilat AKEP-i po i përdor si referencë. Vodafone ka qenë gjithnjë kundër çdo lloj reduktimi të ndjeshëm të tarifave të terminimit (pra brenda 2018 në këtë rast) pasi kjo përbën rrezik real për qëndrueshmërinë financiare të operatorëve në treg dhe do të ndikonte negativisht në nivelin e investimeve.

Në këtë pjesë, Vodafone kundërshton gjithashtu vlerësimin e impaktit financiar të kryer nga AKEP-i, i cili është tërësisht jo realist. AKEP-i pretendon që ndikimi në kosto është shumë i ulët me një rritje të vogël në nivelin 0.10% lek/min dhe madje një reduktim prej 0.12% lek/min karahasuar me raportin e 2017.

Ndërkohë që nga analiza financiare e kryer nga ana jonë, nëse do të ruheshin të njëjtat parametra me vitin 2017 (duke shpërndarë trafikun e operatorit Plus në mënyrë proporcionale te 3 operatorët e tjerë) impakti i llogaritur është afërsisht 5 milionë Euro vetëm për fazën e parë të glide path të propozuar. Në terma financiar Shoqëria Vodafone do të pësonte një ulje drastike të të ardhurave në vlerën 2,4 milion Euro dhe rritje të kostove në lidhje me interkoneksionin kombëtar në vlerën 2,6 milion Euro.

Për sa më sipër, analiza mbi impaktin financiar dhe shifrat e përmendura nga AKEP në dokument nuk janë të sakta. AKEP shprehet se kosto prej 2.43 lekë/minutë (sipas MTR të fazës së parë) është më e ulët se kostoja e ponderuar e thirrjeve on-net dhe off-net të vitit 2017 të Vodafone prej 2.55lek/min sipas MTR të zbatuar në 2017 (6.52 lekë/minutë për Plus dhe 1.48



lek/min për tre operatorët e tjerë), pra skema e re MTR çon në ulje të kostos së thirrjeve të Vodafone me 0.12 lekë/min. Arsyetimi mbrapa kësaj llogjike të ndjekur nga AKEP është i gabuar pasi jo vetëm që nuk është kryer një analizë e saktë e tregut me daljen e Plus dhe efektet përkatëse, por dhe shifrat e paraqitura janë të pasakta për arsye se MTR i aplikuar me Plus ka qenë 2.66 dhe jo 6.52. Për më tepër Vodafone nuk ka pranuar asnjëherë aplikimin e asimetrisë me Plus dhe kjo çështje ka qenë objekt konflikti gjyqësor, i cili është zgjidhur me anë të një marrëveshje për zgjidhjen e të gjitha konflikteve gjyqësore ("Settlement Agreement").

## Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me komentet e Telekom Albania dhe Vodafone Albania, se nivelet 1.22 apo 1.11lek/minutë nuk janë nivelet e duhura dhe të arsyeshme për tregun në Shqipëri, AKEP sqaron se ka dhënë përgjigje në këtë dokument dhe në qendrimin ndaj komentve të përgjithshme, duke theksuar njëkohësisht se niveli 1.22 lek/minutë është propozuar nga AKEP që në Dhjetor 2016 në dokumentin e parë të këshillimit publik për MTR, duke propozuar datën 1.09.2017 për hyrjen në fuqi të saj.

Në lidhje me komentet për impaktin financiar, AKEP sqaron se ato janë bazuar në trafikun e shkëmbyer midis tre MNO-ve, duke përjashtuar trafikun e tyre me Plus, për vitin 2017. Trafiku i shkëmbyer midis 3 MNO-ve mund të ketë ndryshime të rëndësishme në varësi të shumë faktorëve, përfshirë edhe daljen nga tregu të Plus.

Gjithsesi, AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik dhe propozimet përkatëse, përfshirë impaktin financiar të rregullimit të MTR ka marrë në konsideratë trafikun mujor të shkëmbyer midis 3 MNO-ve në katër vitet e fundit Janar 2014-Dhjetor 2017.

AKEP ka përfshirë në kapitullin e efekteve, impaktin e reduktimit të MTR, i cili synon të reduktojë kostot me shumicë të tre operatorëve për thirrjet off-net, dhe rrjedhimisht dhe konkurrencën midis tyre.

## Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

---

<b>Simboli</b>	<b>Shteti</b>
<b>AL</b>	Shqipëri
<b>AT</b>	Austri
<b>BE</b>	Belgjik
<b>BG</b>	Bullgari
<b>CH</b>	Zvicër
<b>CY</b>	Qipro
<b>CZ</b>	Çeki
<b>DK</b>	Danimarkë
<b>DE</b>	Gjermani
<b>EE</b>	Estoni
<b>EL</b>	Greqi
<b>ES</b>	Spanje
<b>FI</b>	Finlandë
<b>FR</b>	Francë
<b>HR</b>	Kroaci
<b>HU</b>	Hungari
<b>IE</b>	Irlandë
<b>IS</b>	Islandë
<b>IT</b>	Itali
<b>LI</b>	Liechtenstein
<b>LT</b>	Lituani
<b>LV</b>	Letoni
<b>LU</b>	Luksemburg
<b>ME</b>	Mali i Zi
<b>MT</b>	Malta
<b>FYROM</b>	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>NL</b>	Hollandë
<b>NO</b>	Norvegji
<b>PL</b>	Poloni
<b>PT</b>	Portugali
<b>RO</b>	Rumani
<b>RS</b>	Serbi
<b>SE</b>	Suedi
<b>SI</b>	Sllloveni
<b>SK</b>	Slllovaki
<b>TR</b>	Turqi
<b>UK</b>	Mbreteria e Bashkua(Angli)